



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.95**

**23 korrik**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.461, datë 9.6.2010	Për miratimin e strategjisë “Për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer, 2010-2015” dhe planit të veprimit të saj ... 5063
Vendim i KM nr.478, datë 16.6.2010	Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie ..... 5091
Vendim i KM nr.522, datë 30.6.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga shpronësimi për qëllim të ndërtimit, pronësisë, shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe transferimit në favor të shtetit të projektit të një hidrocentrali të ri në Ashtë, në qarkun e Shkodrës ..... 5092

**VENDIM**  
**Nr.461, datë 9.6.2010**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË “PËR RIINTEGRIMIN E SHTETASVE SHQIPTARË  
TË KTHYER, 2010-2015” DHE PLANIT TË VEPRIMIT TË SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e strategjisë “Për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer, 2010-2015” dhe planit të veprimit të saj, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**STRATEGJIA PËR RIINTEGRIMIN E SHTETASVE  
SHQIPTARË TË KTHYER  
2010-2015**

**Hyrje**

Migracioni përbën një aspekt të rëndësishëm të marrëdhënieve të Shqipërisë me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për faktin se ato kanë qenë vende destinacioni për shumicën e emigrantëve shqiptarë, si dhe në kuadër të përpjekjeve të Shqipërisë për t’u anëtarësuar në Bashkimin Evropian.

Politika migratore e Republikës së Shqipërisë përbëhet nga politikat emigratore dhe imigratore, të shprehura këto në normativën migratore të hartuar dhe miratuar për këtë qëllim, e cila është në përputhje me normativën e BE-së. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, e cila përfaqëson kuadrin strategjik për politikat dhe reformat e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, përfshin edhe vizionin e Qeverisë në lidhje me migracionin, i cili është trajtuar gjerësisht në Strategjinë Kombëtare për Migracionin. Ky vizion konsiston në sigurimin e një politike më të plotë për migracionin, të bazuar në ngritjen dhe funksionimin e një sistemi kombëtar menaxhues të migracionit. Politikat migratore për shtetasit shqiptarë synojnë minimizimin e kostove të migracionit dhe maksimizimin e përfitimeve si për emigrantët, ashtu dhe për vendin, përmes parandalimit të migracionit të parregullt, nxitjes së kthimit vullnetar dhe promovimit të lidhjes migracion-zhvillim i vendit.

Strategjia për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer është pjesë e politikave kombëtare për migracionin. Ajo zgjeron më tej parashikimet e Strategjisë Kombëtare për Migracionin në lidhje me riintegrimin e emigrantëve shqiptarë të kthyer, të cilat nuk adresojnë në mënyrë të plotë çështjet e riintegrit. Vizioni i saj është siguri i një kthimi të qëndrueshëm për emigrantët përmes mbështetjes së procesit të riintegrit, pavarësisht formës së kthimit.

Strategjia shënjestron në radhë të parë shtetasit shqiptarë të kthyer në kuadër të Marrëveshjes së Ripranimit KE-Shqipëri dhe marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit që Shqipëria ka nënshkruar me vende të tjera, ose përmes formave të tjera të kthimit të detyruar. Gjithashtu, kjo strategji paracakton mekanizmat që vlejné dhe adresojné edhe shtetasit shqiptarë të kthyer vullnetarisht. Për këtë, strategjia përmirëson mekanizmin ekzistues, duke u mbështetur në disa parime bazë:

- Shmangien e diskriminimit pozitiv për pjesën tjetër të popullatës jomigratore. Kjo nënkupton se “Mbështetja për riintegrim” konsiston kryesisht në përmirësimin e informimit të shtetasve shqiptarë të kthyer mbi shërbimet publike ekzistuese tek të cilat kanë akses të gjithë shtetasit shqiptarë sipas kriterëve të përcaktuara nga kuadri ligjor shqiptar, dhe jo në ofrimin e shërbimeve specifike për të kthyerit. Shërbime specifike ofrohen vetëm për kategori të caktuara shtetasish shqiptarë të kthyer, në përputhje me parashikimet ligjore (si p.sh. viktimat trafikimi, të mitur të pashoqëruar, romë, emigrantë me probleme ekonomike etj.), apo përmes projekteve/programeve specifike të hartuara dhe zbatuara me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm.

- Në vullnetin e lirë të të kthyerve për t’u përfshirë në mekanizmin publik të informimit dhe të mbështetjes për riintegrim.

- Përdorimin e strukturave ekzistuese institucionale dhe fuqizimin e tyre.

- Promovimin e shërbimeve publike përmes nxitjes së komunikimit institucional dhe informimit të vazhduar të shtetasve shqiptarë të kthyer dhe popullatës në përgjithësi.

- Nxitjen e bashkëpunimit mes strukturave publike dhe shoqërisë civile për hartimin dhe zbatimin e programeve specifike në ndihmë të riintegrimit të shtetasve shqiptarë të kthyer.

- Barazinë dhe ndjeshmërinë gjinore; trajtimin e barabartë të shtetasve shqiptarë të kthyer nga pikëpamja gjinore dhe adresimin e nevojave të tyre në përputhje edhe me specifikat gjinore.

Dokumenti i Strategjisë organizohet në 4 kapituj. Kapitulli i parë pasqyron historikun e emigracionit shqiptar, të bazës ligjore dhe institucionale, si dhe të ecurisë së masave të riintegrimit të ndërmarra deri tani në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin. Kapitulli i dytë pasqyron vizionin e Strategjisë, detajon elementet bazë të listuara më sipër, objektivat dhe masat për të ardhmen. Kapitulli i tretë pasqyron modalitetet e llogaridhënies dhe monitorimit të zbatueshmërisë së Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Kapitulli i katërt përmban Planin e Veprimit të Strategjisë në të cilin pasqyrohen masat konkrete për veprim për të gjitha institucionet e ngarkuara me zbatimin e tyre. Në shtojcën e dokumentit paraqitet terminologjia e përdorur në dokument.

Dokumenti njih kontributin e donatorëve dhe shoqërisë civile në Shqipëri në ofrimin e shërbimeve të riintegrimit për shtetasit shqiptarë të kthyer dhe nxit bashkëpunimin e tyre me institucionet shtetërore për këtë qëllim.

Strategjia për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer zbatohet në periudhën 2010-2015.

#### **Tabela e shkurtimeve**

AKAFP	Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional
BE	Bashkimi Evropian
DAR	Drejtoria arsimore rajonale
DKM	Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPMKR	Drejtoria e Politikave të Migracionit, Kthimit dhe Riintegrimit
DPP	Drejtoria e Politikave të Punësimit
DRKM	Drejtoria rajonale për kufirin dhe migracionin
DRVP	Drejtoritë rajonale dhe vendore të punësimit
DSHJ	Drejtoria e Shërbimeve Juridike
ISKSH	Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor
ITAP	Instituti i Trajnimeve të Administratës Publike

IZHA	Instituti i Zhvillimit të Arsimit
KE	Komisioni European
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MB	Ministria e Brendshme
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MD	Ministria e Drejtësisë
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
MF	Ministria e Financave
MPÇSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPPT	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
ONM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
PAK	Persona me aftësi të kufizuara
PKK	Pikat e kalimit kufitar
PKVM	Plani Kombëtar i Veprimit për Migracionin
SKM	Strategjia Kombëtare për Migracionin
SM	Sporte migracioni
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
ZA	Zyrat arsimore

## 1. Përshkrim i përgjithshëm

### 1.1 Historik i emigracionit shqiptar

Emigrantët shqiptarë sot në botë vlerësohet të përbëjnë rreth 27,5 % të popullsisë së përgjithshme<sup>1</sup> dhe 35% të popullsisë aktive. Greqia dhe Italia janë identifikuar si vende parësore të destinacionit, të ndjekura nga Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Kanadaja, Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj. Përgjatë viteve, migracioni i kthimit ka lindur si një tjetër dukuri brenda migracionit shqiptar për arsye të ndryshme që lidhen me arsyet e emigracionit, me situatën e personit që ka emigruar apo kontekstin familjar. Këta faktorë shpesh konsiderohen se ndikojnë tek kthimi vullnetar. Nga ana tjetër përvojat e kthimit mund të lindin nga përvoja negative e migracionit si: dështimi në marrjen e statusit të rregullt në vendet e destinacionit, kthimi i detyruar si pasojë e qëndrimit të paligjshëm në vendet e destinacionit, sipas përcaktimeve në marrëveshjet e ripranimit apo praktikave të tjera të kthimit në vendin e origjinës.

Në përgjithësi emigrantët shqiptarë me status të parregullt në BE, veçanërisht ata që jetojnë në Itali dhe në Greqi, kanë qenë më të ekspozuar ndaj kthimit të detyruar sesa emigrantët me status të rregullt të kthyer vullnetarisht. Sipas statistikave zyrtare të Ministrisë së Brendshme, gjatë vitit 2009 janë regjistruar 64.625 raste kthimi ose 47.239 shtetas shqiptarë të kthyer, prej të cilëve 38.412 janë raste të kapura në kufi ose në afërsi të kufirit dhe 26.213 raste të kapura në thellësi të territoreve të vendeve të origjinës.

Të ndarë sipas gjinisë, 62.331 raste ose 34.940 persona kanë qenë meshkuj dhe 2294 raste ose 12.299 persona kanë qenë femra; të ndarë sipas moshës, 11.236 raste ose 6.741 persona kanë qenë minorene meshkuj dhe 452 raste ose 388 persona kanë qenë minorene femra. Motivi i emigrimit në 99.99% të rasteve ka qenë për punësim.

Pavarësisht formave të kthimit vullnetar apo të detyruar, të kthyerit mund të klasifikohen si investitorë të mundshëm, emigrantë të kualifikuar ose pa profesion pas kthimit. Po ashtu, ndërhyrjet që lehtësojnë përvojën e kthimit duhet të jenë të ndryshme në varësi të nevojave të personave në secilën kategori. Këto ndërhyrje duhet të sigurojnë riintegrimin e personave të kthyer me qëllim

<sup>1</sup> UNDP, Human Development Report 2009.

qëndrueshmërinë e kthimit. Qeveria Shqiptare është e motivuar të mbështesë kthimin dhe riintegrimin e shtetasve të saj për të siguruar një kthim të qëndrueshëm në vend, si dhe maksimizimin e të mirave të migracionit.

#### 1.2 Kuadri i politikave dhe legjislacionit për kthimin dhe riintegrimin në Shqipëri

- Procesi i integrimit në BE dhe detyrimet që parashtron ky proces

Qeveria Shqiptare i ka dhënë rëndësi parësore çështjes së integrimit në BE duke përcaktuar prioritetet përkatëse në Planin e Veprimit për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013. Ndër çështjet e një rëndësie të veçantë në procesin e Stabilizim-Asociimit vlerësohen zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit Kombëtar i Veprimit, Marrëveshja e Lehtësimit të Vizave dhe Marrëveshja e Ripranimit, kjo edhe në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave me Bashkimin Evropian.

Strategjia Kombëtare për Migracionin është dokumenti përmbledhës i politikave qeveritare shqiptare për migracionin, të cilat synojnë kryesisht dekurajimin e flukseve reale dhe potenciale të emigrantëve, si dhe forcimin e lidhjes emigracion-zhvillim. Gjithashtu, bazuar në nenin 81 të MSA-së, Shqipëria nënshkroi më 14 prill të vitit 2005, Marrëveshjen e Ripranimit me Bashkimin Evropian për personat të cilët qëndrojnë pa autorizim, duke qenë kështu shteti i parë në Evropë që ndërmori një hap të tillë; marrëveshja hyri në fuqi në 1 maj 2006 për shtetasit shqiptarë dhe në 1 maj 2008 për shtetasit e vendeve të treta. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Ripranimit i parapriu hapjes së negociatave me BE-në me qëllim realizimin e Marrëveshjes së Lehtësimit të Vizave. Kjo e fundit u nënshkrua më 18 shtator 2007 dhe hyri në fuqi më 1 janar të vitit 2008 dhe aktualisht është në zbatim. Të gjithë këto dokumente strategjike parashtrajnë nevojën e riintegrimit të shtetasve të kthyer për të garantuar qëndrueshmërinë e kthimit.

- Politikat kombëtare dhe kuadri ligjor lidhur me kthimin

Plani Kombëtar i Veprimit për Migracionin (PKVM), pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare për Migracionin, parashikon masat e Qeverisë Shqiptare për menaxhimin e flukseve të emigracionit dhe hartimin e një politike të plotë për migracionin. Ky plan përmban masa të cilat trajtojnë si kthimin vullnetar, ashtu edhe atë të detyruar përmes zbatimit të marrëveshjeve të ripranimit<sup>2</sup>. Për shkak të numrit të lartë të të kthyerve përmes ripranimit, paragrafi në vijim do të ndalet veçanërisht në çështjen e ripranimit.

Marrëveshjet e ripranimit, si edhe protokollat e zbatimit nga Republika e Shqipërisë konsiderohen instrumente të nevojshme ligjore të cilat rregullojnë procedurat e ripranimit duke ndihmuar në kthimin e shpejtë dhe dinjitoz të shtetasve shqiptarë, dhe në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut. Marrëveshja e Ripranimit të Personave me qëndrim të paautorizuar në Bashkimin Evropian u nënshkrua më 14 prill 2005 dhe hyri në fuqi më 1 maj 2006 për shtetasit shqiptarë dhe në 1 maj 2008 për shtetasit e vendeve të treta. Marrëveshja ka për qëllim të forcojë më tepër bashkëpunimin efektiv për të luftuar emigracionin ilegal dhe të vendosë procedura të qarta dhe të thjeshta për identifikimin dhe kthimin e sigurt të personave të cilët nuk plotësojnë kushtet e hyrjes, të pranisë apo qëndrimit të rregullt në territoret respektive të Shqipërisë apo të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian, si edhe të lehtësojë kalimin tranzit të këtyre personave.

Në bazë të kësaj marrëveshjeje, Shqipëria ka detyrimin për të ripranuar të gjithë ata persona të cilët nuk i plotësojnë kushtet e sipërpërmendura, pasi është provuar se ata janë shtetas shqiptarë, apo shtetas të tjerë që kanë përdorur territorin shqiptar për të hyrë në një shtet anëtar të BE-së. Protokolle të zbatimit të Marrëveshjes së Ripranimit me BE-në janë nënshkruar me shtetet: Itali, Belgjikë, Mbretëri e Bashkuar, Hungari, Rumani, Republika Çeke, Sllovakia, Austri, Luksemburg, Holandë, Danimarkë. Janë gjithashtu në proces negocimi protokollat e zbatimit me Greqinë, Slloveninë, Portugalinë, Maltën, Francën, Çekinë. Këto protokolle zbatimi kanë për synim

---

<sup>2</sup> Masa 5 përcakton “Zbatimi i marrëveshjeve të ripranimit” dhe Masa 10 “Zbatimi i Marrëveshjeve të Ripranimit, duke përfshirë KE/Shqipëri dhe ato në lidhje me shtetasit e vendeve të treta”

vendosjen e modaliteteve dhe procedurave më të thjeshtuara për praktikën e ripranimit të personave. Me vendet jo anëtare të BE-së, Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje të ripranimit dhe protokolle të zbatimit me shtetet: Zvicër, Kroaci, Maqedoni, Bosnjë-Hercegovinë, Norvegji, Islandë, Mali i Zi, Kosovë, dhe aktualisht është në proces negocimi marrëveshja e ripranimit me Moldavinë.

Baza ligjore për kthimin dhe ripranimin përbën një pjesë të së drejtës migatore në Shqipëri. Legjislacioni vendas i cili trajton çështjet e ripranimit përmbledhet në:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 84, datë 21.10.1998, botuar në Fletoren Zyrtare nr.28, datë 7.12.1998, faqe 1073;

- Ligjin “Për Policinë e Shtetit”, nr.9749, datë 4.5.2007, botuar në Fletoren Zyrtare nr.73, faqe 2171, datë 19.6.2007, hyrë në fuqi datë 4.7.2007;

- Ligjin nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.124, faqe 5479, datë 1.8.2008 dhe hyrë në fuqi në datë 1.12.2008.

- Politikat kombëtare dhe kuadri ligjor lidhur me riintegrimin

PKVM parashikon masat që duhen ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer. Ky dokument në kapitullin A2 “Kthimi i shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së” rekomandon masa specifike në ndihmë të riintegrimit të shtetasve të kthyer, si më poshtë vijojnë:

<b>NNr.</b>	<b>Masa</b>	<b>Aktiviteti</b>
6	Përgatitja dhe shpërndarja e broshurave që u drejtohen emigrantëve mbi kthimin vullnetar, ku të jepet informacion në lidhje me statusin dhe të drejtat e tyre, si edhe për shërbimet që u ofrohen nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, si edhe nga shoqatat e emigrantëve me mbështetjen e organizatave kombëtare ose ndërkombëtare.	Botimi i pamfleteve që ofrojnë informacion për procedurat e kthimit në Shqipëri, shërbimet sociale për riintegrim që disponohen etj.
7	Pritja e të miturve të pashoqëruar të kthyer (që nuk bëjnë pjesë në kategorinë e viktimave të trafikuar), në pikat kufitare.	Krijimi i mekanizmave të duhur për referim në pikat e hyrjes dhe sigurimi i ambienteve të nevojshme të pritjes.
8	Zgjerimi i shërbimeve riintegruese në mënyrë që të garantohet kthim i përhershëm.	1. Hartimi dhe zbatimi i programeve të përbashkëta të punësimit me bizneset private. 2. Ofrimi i shërbimit të këshillimit për karrierën, hyrjen në punë dhe formimit profesional.
9	Ngritja e kapaciteteve të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrave të tij, lokale dhe rajonale.	Programe specifike për trajnimin lidhur me asistencën për të kthyerit.
11	Sigurimi i informacionit të nevojshëm dhe informimi i të kthyerve mbi mundësitë e kthimit vullnetar në atdhe.	1. Caktimi i personave përgjegjës për dhënien e informacionit dhe ndihmës së nevojshme në pikat kufitare. 2. Hartimi dhe shpërndarja e posterave dhe pamfleteve informative për kthimin vullnetar, avantazhet e tij, të drejtat e migrantëve.

Gjithashtu masa të tjera të PKVM-së, të cilat trajtojnë çështje të kthimit dhe riintegrit të shtetasve shqiptarë, janë:

Masa 3: Vlerësimi i mundësive konkrete që ofron Strategjia për Punësimin dhe Formimin Profesional për shtetasit shqiptarë të kthyer; Masa 54: Zhvillimi i politikave me qëllim nxitjen e kthimit të shtetasve shqiptarë të kualifikuar; Masa 57: Ratifikimi i instrumenteve ndërkombëtare në fushën e migracionit; Masa 58: Miratimi i akteve ligjore të reja dhe ndryshimi i akteve ligjore ekzistuese në fushën e emigracionit për zgjerimin e sferës së mbrojtjes së emigrantëve në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Janë disa strategji të miratuara dhe në proces zbatimi nga Qeveria Shqiptare të cilat synojnë, ndër të tjera, të sigurojnë mbrojtje sociale për grupet më në nevojë, përfshirë edhe shqiptarë të kthyer nga emigracioni, që janë pjesë e këtyre grupeve në nevojë.

Kështu, çështje, si kthimi dhe riintegrimi i shtetasve shqiptarë, ngritja e shërbimeve të punësimit dhe të formimit profesional për ta, ngritja e shërbimeve sociale për grupet më në nevojë, kthimi dhe riintegrimi i viktimave të trafikimit, i fëmijëve vulnerabël apo të braktisur, janë në fokus të disa strategjive, si: Strategjia Sektoriale e Punësimit dhe Formimit Profesional 2007-2013; Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013; Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013; Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010 dhe Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit<sup>3</sup>, Strategjia Kombëtare për Fëmijët 2005-2010; Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom, si dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2010 - 2015.

Gjithashtu është në fuqi Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për Mbrojtjen dhe Asistencën e Fëmijëve, Viktima të Trafikimit, ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr. 9544, datë 29.5.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktima të trafikimit"<sup>4</sup>. Kjo marrëveshje është ratifikuar nga Parlamenti Grek me ligjin nr. 3692/25.08.2008. Nenet 7.2, 8.1, 14 dhe trajton kthimin dhe trajtimin e fëmijëve, viktima të trafikimit.

Nga pikëpamja ligjore ofrimi i shërbimeve të riintegrit dhe tipologjia e shërbimeve përcaktohen në një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore në zbatim të tyre:

- Ligji nr.9668, datë 18.12.2006 "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi" parashikon marrjen e masave dhe ofrimin e shërbimeve riintegruese për emigrantët e kthyer në nenet 8, 9, dhe 12 të tij. Në zbatim të ligjit "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi" janë hartuar dhe miratuar:

- Urdhri i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr.1772, datë.18.9.2007 "Për formën, përmbajtjen e dokumentit dhe procedurën e përfitimit të statusit të emigrantit";

- Urdhri nr.2086, datë 13.11.2007 "Për formën, përmbajtjen e regjistrimit për emigrantët dhe procedurat e regjistrimit";

- Ligji nr.7952, datë 21.06.1995 "Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", në nenin 11 parashtron të drejtën e personave me kombësi shqiptare që jetojnë jashtë Shqipërisë për t'u arsimuar. Pranimi i tyre bëhet sipas akteve nënligjore të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, dhe specifikisht në bazë të udhëzimit nr.11, datë 2.4.2010 "Për kriteret e ekuivalentimit e dëftesave të shkollave të mesme dhe regjistrimin në Maturën Shtetërore 2010 të shtetasve shqiptarë që kanë kryer studimet jashtë shtetit".

- Ligji nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar me ligjin nr.10252, datë 11.3.2010, në nenin 5/pika 4 ka përcaktuar si përfitues të ndihmës ekonomike,

<sup>3</sup> Ndërkohë, Shqipëria ka ratifikuar një numër të madh konventash në fushën e mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve gjë që tregon angazhimin e vendit për të arritur standardet më të mira në këtë drejtim.

<sup>4</sup> Fletorja Zyrtare: Viti 2006, Nr.63, Faqe 1731, Data e botimit: 22.06.2006.

viktimat e trafikimit pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre.

- Ligji nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, në nenin 2, pika 20, përcakton si grup të veçantë emigrantët e rikthyer me probleme ekonomike.

- Në zbatim të këtij ligji, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9 2003 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra” parashikon nxitjen e punësimit të femrave të trafikuar.

- Po ashtu në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.616, datë 4.12.2002 “Për përcaktimin e kategorive të tjera të grupeve të veçanta që përfitojnë nga ligji nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, është parashikuar kategoria e personave që kthehen nga emigracioni me probleme ekonomike.

### 1.3 Kuadri institucional për kthimin dhe riintegrimin

Kuadri institucional ekzistues për menaxhimin e migracionit është ai që mbulon edhe çështjet e kthimit dhe riintegrimin dhe paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

1. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është nga ministritë kryesore përgjegjëse për zbatimin e një sërë masash të PKVM përmes drejtorive përkatëse dhe strukturave në varësi, si më poshtë vijojnë:

- Drejtoria e Politikave të Migracionit, Kthimit dhe Riintegrimit, e cila është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave për migracionin.

- Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Formimit Profesional, e cila harton dhe miraton programet aktive dhe pasive të punësimit dhe formimit profesional në vend, përfshi edhe caktimin e kategorive që përfitojnë nga këto programe (si p.sh. emigrantët e kthyer me probleme ekonomike).

- Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP), i cili operon nëpërmjet zyrave të punësimit, rajonale dhe vendore. Në këto zyra janë ngritur struktura të posaçme, të quajtura sportelet e migracionit (në 12 zyra rajonale dhe në 2 zyra lokale punësimi) për informimin e shtetasve që dëshirojnë të emigrojnë në mënyrë të rregullt dhe të atyre që kthehen e dëshirojnë të riintegrohen dhe qëndrojnë në Shqipëri.

- Shërbimi Social Shtetëror ndjek zbatimin e politikave dhe të legjisllacionit në fushën e shërbimeve sociale. PKVM nuk e ngarkon me detyra specifike këtë institucion për migrantët e kthyer. Sidoqoftë kjo strukturë është pjesë e Mekanizmit Kombëtar të Identifikimit dhe Referimit të Viktimave të Trafikimit.

2. Ministria e Punëve të Jashtme koordinon procesin e negociatave dypalëshe dhe/ose shumëpalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera (përfshi këtu edhe marrëveshjet e ripranimit apo ato të emigrimit për qëllime punësimi). Shërbimi Konsullor Shqiptar nën varësinë e kësaj ministrie, në bashkëpunim me strukturat e Ministrisë së Brendshme, përgjigjen për lëshimin e dokumenteve dhe lejekalimeve të shtetasve shqiptarë që kthehen përmes marrëveshjeve të ripranimit, si edhe për informimin mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre.

3. Ministria e Brendshme është një nga aktorët kryesorë të menaxhimit të migracionit në vend, për aspekte që kanë të bëjnë me hyrjen, qëndrimin, tranzitimin dhe daljen nga Republika e Shqipërisë dhe në veçanti për zbatimin e marrëveshjeve të ripranimit.

- Departamenti i Policisë Kufitare dhe Migracionit në Policinë e Shtetit është përgjegjës për zbatimin në praktikë të marrëveshjeve të ripranimit, aktivitet i cili përfshin pranimin e kërkesave për ripranim dhe kthimin e përgjigjeve, pritjen, intervistimin dhe përzgjedhjen e të kthyerve, duke i ndarë në viktimat trafiku apo viktimat të mundshme trafiku, në të kontrabanduar, apo klandestinë që kanë kaluar vetë kufirin, dhënien e asistencës së nevojshme humanitare ndaj të kthyerve sipas kërkesës, si dhe marrjen e masave për të lehtësuar transportin e të kthyerve deri në qendrat më të afërta urbane.

- Koordinatorin Kombëtar Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore pranë kësaj ministrie drejton dhe monitoron Mekanizmin Kombëtar të Referimit të Viktimave të Trafikimit, si dhe të të miturve të pashoqëruar.



- Drejtoria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, e cila përgjigjet për regjistrimin e popullsisë në gjendjen civile, përfshi fëmijët e lindur jashtë vendit nga emigrantët.

4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës përgjigjet që personat me kombësi shqiptare që jetojnë jashtë territorit të Shqipërisë, të arsimohen në Republikën e Shqipërisë, përmes sigurimit të aksesit në edukim (p.sh. ekuivalentim i diplomave të fituara jashtë vendit, regjistrimit në sistemin arsimor shqiptar).

5. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përmes agjencisë “Albinvest” mundëson që të gjithë shtetasit shqiptarë, investitorë që jetojnë jashtë kufirit shqiptar, të investojnë në vend në fushat me prioritet për vendin.

6. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është përgjegjëse për informimin dhe integrimin e studentëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit (pas kthimit) në bashkëpunim me MASH, MPJ dhe Ministrinë e Integritit.

7. Ministria e Financës, përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, siguron zbatimin e parashikimeve të Kodit Doganor për përjashtime nga taskat doganore për mjetet personale dhe veglat e punës për emigrantët e kthyer.

8. Instituti i Sigurimeve Shoqërore (nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Financave) mundëson përmes skemave të tij, sigurimin vullnetar të emigrantëve në Shqipëri për efekt pensioni.

9. Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për sigurimin e aksesit në kujdesin shëndetësor parësor dhe spitalor të shtetasve shqiptarë pas kthimit, sipas skemës që i ofrohet të gjithë popullatës shqiptare. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor është përgjegjës për pajisjen e shtetasve me librezën e shëndetit pas pagimit të kontributit të sigurimit shëndetësor ose pas verifikimit të statusit të tyre në rastet kur sigurohen nga shteti. Drejtoritë e shëndetit publik në çdo rreth janë përgjegjëse për informimin e shtetasve rreth të drejtave dhe rrugëve ligjore për të siguruar aksesin në shërbimet shëndetësore, për të siguruar dhe mbështetur vaksinimin e tyre, për të informuar rreth rreziqeve për shëndetin dhe mënyrave të mbrojtjes. Mjeku i familjes është porta e sistemit shëndetësor. Çdo shtetas është i lirë të zgjedhë mjekun e familjes dhe më pas, në bazë të një sistemi referimi të miratuar, kalon në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, pa pagesë në rast se është i siguruar, dhe zbaton sistemin e referimit dhe kundrejt pagesës në rast se është i pasiguar apo nuk respekton sistemin e referimit.

10. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit zbaton politika mbështetëse për banorët e zonave rurale për: sektorët e prodhimit të frutave, ullinjve, rrushit, mishit, qumështit, ruajtjen, tregtimin e prodhimeve nëpërmjet ndërtimit të qendrave frigoriferike, prodhimet e produkteve bio, si dhe mbulon një pjesë të interesit të kredive për agro-përpunim. Gjithashtu përfitues të këtyre politikave mbështetëse për zhvillimin e zonave rurale është dhe popullsia e emigrantëve të kthyer në Shqipëri të cilët banojnë në zona rurale. Struktura operative për zbatimin dhe mbështetjen e këtyre politikave është Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Bujqësore dhe Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR).

1.4 Analizë e zbatueshmërisë së politikave dhe legjislacionit vendas për riintegrimin e shtetasve të kthyer (problematikat e hasura)

Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Veprimit për Migracionin, institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë një sërë aktivitete dhe masash në mbështetje të procesit të riintegrit të shtetasve shqiptarë të kthyer. Kështu, në bashkëpunim me ONM, dhe mbështetjen financiare të BE-së përmes programit CARDS 2004 dhe Qeverisë Italiane, Ministria e Punës ka ndërmarrë në vitin 2008 një studim vlerësues për mundësitë dhe kapacitetet e strukturave ekzistuese për formimin profesional të shtetasve shqiptarë që kthehen në Shqipëri<sup>5</sup>. Është kryer gjithashtu mbledhja e të dhënave mbi shtetasit shqiptarë të kthyer, karakteristikat socio-demografike të tyre, si

---

<sup>5</sup> “Identifikimi i mundësive ekzistuese për formimin profesional të migrantëve të kthyer në Shqipëri: mangësi dhe rekomandime”.

dhe shërbimet riintegruese për të cilat kanë nevojë shtetasit shqiptarë të kthyer, përmes realizimit të një tjetër studimi<sup>6</sup>. Të dy studimet theksojnë nevojën për përcaktimin e shërbimeve riintegruese, si dhe forcimin e kapaciteteve të strukturave ekzistuese për të ofruar shërbime riintegrimi. Në kuadër të të njëjtit projekt janë hartuar dhe shpërndarë në pikat e kalimit kufitar të Shqipërisë, konsullata shqiptare në disa vende të BE-së dhe në zyrat rajonale dhe lokale të punësimit një sërë materialesh informuese në lidhje me shërbimet që ofrojnë strukturat shtetërore shqiptare për shtetasit brenda dhe jashtë vendit (Në këtë kuadër vlen të përmendet hartimi i “Përmbledhje procedurash dhe kontaktesh të nevojshme në ndihmë të riintegrit të emigrantëve shqiptarë pas kthimit në Shqipëri”).

Paralelisht aktiviteteve për informimin e emigrantëve mbi shërbimet e riintegrit janë ndërmarrë masa specifike për forcimin e kapaciteteve të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, nën varësinë e të cilit janë sportelet e migracionit, struktura përgjegjëse lokale për ofrimin e shërbimeve të riintegrit. Përmes financimeve të ndryshme, kryesisht nga BE-ja, janë rritur kapacitetet e zyrave rajonale e vendore të punësimit nëpërmjet trajnimeve për rritjen e njohurive për shërbimet e riintegrit për shtetasit shqiptarë të rikthyer, përmirësimit të infrastrukturës së tyre me kompjuterë dhe mobilie, si dhe vizitave studimore në vende të tjera.

Sportelet e migracionit, tashmë funksionale, japin informacion mbi mënyrat e rregullta të emigrimit, si dhe mundësitë e riintegrit pas kthimit. Këto zyra administrojnë edhe regjistrin për shtetasit shqiptarë të rikthyer nga emigracioni, përfshirë të ripranuarit. Sidoqoftë vihet re se sportelet e migracionit kanë nevojë për t’u përforcuar për të maksimizuar ofrimin e shërbimeve, përmes trajnimit, si dhe ofrimit të suportit teknik (përfshi lidhjen e vazhduar me internet, përditësimin e informacionit etj.). Për më tepër vihet re se në përgjithësi ka pak informacion mbi shërbimet që ofrojnë Sportelet e migracionit dhe zyrat rajonale dhe lokale të punësimit nga pikëpamja e shërbimeve të riintegrit për shtetasit shqiptarë të kthyer, pavarësisht aktiviteteve promociionale (përmes spoteve televizive, fletëpalosjeve, etj.). Kjo bën që rregjistri i emigrantëve të ketë shumë pak të dhëna krahasimisht në raport me numrin e të kthyerve në vend.

Në përgjithësi vlerësohet se masat e riintegrit të PKVM nuk adresojnë në mënyrë të plotë nevojat për riintegrim të shtetasve shqiptarë të kthyer, sepse nuk ekziston një mekanizëm i mirëpërcaktuar informimi në lidhje me shërbimet publike në vend, si dhe referimi tek këto shërbime, në mënyrë të vazhduar. Për më tepër masat janë shpesh të karakterit përgjithësues dhe gama e tyre fokusohet vetëm drejt shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional ndërkohë që nevojat e shtetasve shqiptarë të kthyer nuk përmbledhen vetëm në shërbime punësimi dhe formimi profesional.

Nga pikëpamja e shërbimeve të riintegrit për disa kategori vulnerabël si viktima të trafikimit dhe të mitur të pashoqëruar, janë krijuar të gjitha mekanizmat ligjorë dhe institucionalë në lidhje me mekanizmat referues në pikat hyrëse të kufirit. Këtu përfshihen edhe akte të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe procedurat e parashikuara në protokollat e zbatimit të marrëveshjeve të ripranimit. Trajnimi i personelit kryhet në mënyrë të vazhdueshme në Akademinë e Policisë me ekspertë të Departamentit të Kufirit dhe Migracionit dhe organizata ndërkombëtare partnere që punojnë në këtë drejtim.

Nga pikëpamja ligjore, zbatimi i ligjit nr.9668, datë 18.12.2006 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, i cili parashikon shërbimet e riintegrit në vend, ka hasur vështirësi në praktikë. Ky ligj përcakton vetëm përgjegjësi të përgjithshme të strukturave shtetërore në procesin e emigrimit, përfshi këtu kthimin dhe riintegrimin. Problemi kryesor që lidhet me zbatueshmërinë e këtij ligji është unifikimi i trajtimit të dy grupeve me karakteristika të ndryshme migratore, emigrantët dhe shtetasit shqiptarë të kthyer, në të njëjtin grup shërbimesh dhe duke iu referuar vetëm një statusi, “statusit të emigrantit”, pa bërë përcaktimet e nevojshme për kriteret e

---

<sup>6</sup> “Identifikimi i zonave më të prekura nga emigracioni dhe migracioni i kthimit në Shqipëri: profili i migrantëve të kthyer”.

përfitimit të shërbimeve për migrantët e kthyer, si dhe lidhjen ndërmjet Statusit dhe shërbimeve ndaj emigrantëve (neni 13 i ligjit nr.9668/2006). Në zbatim të nenit 13 ka dalë urdhri nr.1722, datë 18.9.2007 “Për formën, përmbajtjen e dokumentit dhe procedurën e përfitimit të statusit të emigrantit”. Problemet në zbatueshmërinë e nenit 13 të ligjit janë reflektuar dhe në zbatimin e urdhrin 1722/2007. Ligji, në nenet 8.1, 9.1, 22, 23, parashikon një sërë veprimesh dhe masash në ndihmë të riintegrit të migrantëve të kthyer, si:

- Neni 8.1: ë..të drejtën e informimit dhe të këshillimit falas në fushën e formimit profesional, të shërbimeve të ndërmjetësimit për punësim, të mbrojtjes sociale, të organizimit në sindikata, të mundësive për strehim, arsimim dhe sigurime shoqërore, si dhe të njohjes së kushteve të jetesës e të punës....]

- Neni 9.1: “Autoritetet shtetërore përgjegjëse përjashtojnë nga pagesat doganore dhe taksat emigrantët shqiptarë, që kanë fituar statusin e emigrantit të rikthyer në shtetin e origjinës, për:

a) sendet vetjake dhe pronësitë e luajtshme të punëtorëve migrantë dhe pjesëtarëve të familjes, që i përkasin njësisë familjare;

b) një sasi veglash dore dhe pajisjesh të lëvizshme, të nevojshme për profesionin që do të ushtrojnë.”

- Neni 22.2: “Autoritetet shtetërore përgjegjëse nxisin dhe mbështesin riintegrimin e emigrantëve në jetën ekonomike, sociale dhe politike të vendit, nëpërmjet krijimit të lehtësive fiskale dhe zbatimit të programeve të zhvillimit të biznesit, të punësimit dhe të formimit profesional nëpërmjet punës.”

- Neni 23: “Autoritetet shtetërore përgjegjëse lëshojnë dokumentet e kërkuara nga shtetasit shqiptarë, që do të emigrojnë për qëllime punësimi ose formimi nëpërmjet punës, përfshirë edhe emigrantët e rikthyer, duke respektuar dispozitat ligjore përkatëse në fuqi.”

Ndërkohë, përkufizimi i shtetasit shqiptar të kthyer në nenin 2.14 të ligjit është si vijon:

“Emigrant i rikthyer” është emigranti shqiptar i rikthyer në Republikën e Shqipërisë, për t’u larguar përsëri ose jo, pasi ka kaluar të paktën një vit në shtetin pritës dhe ka qëndruar të paktën një vit në Republikën e Shqipërisë. Të tillë janë edhe refugjatët e riatdhesuar, me dëshirë apo me detyrim, viktimat e trafikimit, të miturit, të burgosurit e luftës dhe diplomatët në kohë krizash” .

Ky përkufizim nuk përcakton qartë lidhjen ndërmjet karakteristikave të klasifikimit të shtetasve shqiptarë të kthyer dhe modaliteteve të dhënies së shërbimeve në kuadrin kohor. Kjo mungesë koherence ndërmjet përkufizimit dhe shërbimit apo procedurave vihet re dhe në pjesë të tjera të ligjit.

Neni 12 i ligjit nr.9668/2006 i referohet regjistrimit të shtetasve shqiptarë të rikthyer. Në zbatim të këtij neni ka dalë urdhri nr.2086, datë 13.11.2007 “Për formën, përmbajtjen e “Regjistrin për emigrantët”, dhe procedurat e regjistrimit”. Por zbatimi i nenit 12 dhe i urdhrin të dalë në zbatim të tij ka hasur probleme. Numri i të regjistruarve është shumë i vogël. Shkak për këtë është mungesa e lidhjes së regjistrimit të tyre me një shërbim të caktuar riintegruës. Kjo lidhje për të rikthyerit nuk shprehet as në ligj. I bazuar mbi vetëdeklarim ekziston mundësia për të rikthyerin të regjistrohet disa herë dhe i mosvërtetimit të statusit të tij. Nuk ka një formë elektronike të njësuar të tij në të gjitha ZRVP-të.

Për rrjedhojë, ligji nuk ka mundur të zbatohet, duke kufizuar dukshëm mundësinë e përcaktimit të një pakete të qartë riintegruese për shtetasit shqiptarë të kthyer në varësi të specifikave të tyre, e cila do të orientonte më pas sportelet e migracionit në referimin drejt shërbimeve ekzistuese.

Nevojat e identifikuara në përmirësimin e shërbimeve në mbështetje të riintegrit në vend paraqiten:

- Krijimi i një baze të dhënash qendrore pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta për shtetasit shqiptarë të kthyer dhe përditësimi i saj periodik. Kjo do të ndihmonte në identifikimin e dukurive demografike në nivel prefekturë dhe do t’u mundësonte institucioneve të përfshira në shërbimet e riintegrit të bënin vlerësime të sakta dhe të përditësuara

të përhapjes së migracionit të kthimit nëpër rajone. Baza e të dhënave do të ndihmonte gjithashtu në monitorimin e asistencës për riintegrim dhe suksesin e saj në vijimësi.

- Për të arritur në një koordinim sa më të mirë të punës, ky proces nxjerr në pah nevojën për mundësimin e marrjes së informacionit paraprak për rastet e kthimit të detyruar, flukset dhe shpërndarjen e tyre nga ana e sporteleve të migracionit, për të përmirësuar bazën e të dhënave, si dhe për të ndihmuar në njohjen e profileve të shtetasve shqiptarë të kthyer përpara referimit të mundshëm drejt strukturave apo shërbimeve të tjera.

- Forcimi i mekanizmit institucional për informimin dhe referimin e shtetasve shqiptarë të kthyer tek shërbimet publike me interes për ta. Nevojitet një komunikim i vazhdueshëm ndërmjet institucioneve që luajnë rol aktiv në njohjen dhe lehtësimin e procesit të kthimit dhe riintegrimit. Ato duhet të shkëmbejnë vazhdimisht informacion, ekspertizë dhe burime me njëra-tjetrën për të qartësuar pozicionin e tyre në procesin e riintegrimit dhe limitet e përfshirjes së tyre, si dhe për të planifikuar rritjen e mëtejshme të kapaciteteve në drejtim të riintegrimit.

- Përmirësimi i bazës ligjore për të mundësuar funksionimin e mekanizmit të referimit në vazhdimësi dhe për të krijuar më shumë hapësirë për grupet në nevojë mes kategorisë së shtetasve shqiptarë të kthyer (PAK, fëmijët, minoritetet, përfshirë romët, personat e trafikuar, shtetasit shqiptarë me probleme ekonomike të kthyer etj.).

- Rritja e kapaciteteve të strukturave ekzistuese të shërbimeve të referimit për shtetasit shqiptarë të kthyer, konkretisht sporteleve të migracionit pranë zyrave rajonale dhe vendore të punësimit.

- Identifikimi i mundësive ekzistuese për formim profesional për shtetasit shqiptarë të kthyer.

- Sigurimi i kushteve të nevojshme për të siguruar vënien në përdorim të aftësive të fituara në emigracion, përfshi ndihmën për punësim, formim profesional, apo edukim të mëtejshëm.

- Nxitjen e shtetasve shqiptarë të kthyer për të kontribuar në zhvillimin e vendit përmes investimit, veçanërisht shtetasit shqiptarë që kthehen në zonat rurale.

- Nxitja e bashkëpunimit me shoqërinë civile për zbatimin e projekteve të përbashkëta në ndihmë të riintegrimit.

## 2. Prioritetet dhe masat për zbatim

Strategjia për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer në Shqipëri ka për qëllim të paraqesë politikën e Qeverisë Shqiptare për mbështetjen e riintegrimit të shtetasve shqiptarë të kthyer në mënyrë vullnetare apo të detyruar në Republikën e Shqipërisë. Kjo politikë konsiston në sigurimin e një kthimi të qëndrueshëm për shtetasit shqiptarë përmes lehtësimit të procesit të riintegrimit, duke synuar minimizimin e kostove të migracionit, maksimizimin e përfitimit dhe nxitjen e kontributit të shtetasve shqiptarë të kthyer në zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo politikë bazohet në disa objektiva që janë:

### 2.1 Përmirësimi i kuadrit ligjor për mbështetjen e riintegrimit

Bazuar edhe në analizën e zbatueshmërisë së kuadrit ligjor dhe të nevojave të identifikuar, strategjia përcakton përmirësimin e bazës ligjore në fushën e emigracionit dhe të punësimit e formimit profesional për ofrimin e shërbimeve në mbështetje të riintegrimit të të kthyerve. Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës ligjore do të realizohen një sërë ndryshimesh në aktet ligjore dhe nënligjore ekzistuese që lidhen me emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi, me qëllim njohjen e këtij grupi të synuar në bazën ligjore dhe mundësimin e ofrimit të mbështetjes për të lehtësuar riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer. Ky proces do të sanksionojë kërkesën për mbledhjen e të dhënave për shtetasit shqiptarë të kthyer të cilëve u ofrohen shërbime mbështetëse për lehtësimin e riintegrimit, si dhe do të përcaktojë kriteret e klasifikimit për përfitimin nga shërbimet e riintegrimit.

Në radhë të parë do të kryhen ndryshime në ligjin nr.9668 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”. Këto ndryshime janë të nevojshme pasi vetë termi emigrant i kthyer, sipas përkufizimit të dhënë në ligj, nuk krijon mundësi që ata të përfitojnë nga shërbimet e

informimit dhe të orientimit që parashikon kjo strategji dhe plani i saj i veprimit. Gjithashtu, lind nevoja e përcaktimit të kriterëve të cilat do bëjnë klasifikimin e një shtetasi shqiptar si emigrant i kthyer, përcaktim i cili duhet të jetë në përputhje me kohën e ofrimit dhe përfitimit të mbështetjes për riintegrim prej tyre.

Gjithashtu, do të ndryshohet neni 8 pika 1 e ligjit nr.9668/2006, në mënyrë që të përcaktohet ofrimi i shërbimit informues dhe referues nga sportelet e migracionit të ngritura në nivel vendor. Përveç kësaj, do të ndryshohet edhe neni 12 i ligjit 9668/2006 që përcakton detyrimin e ngritjes së Regjistrimit të Emigrantëve. Ky ndryshim do të përcaktojë në ligj qëllimin e regjistrimit të tyre dhe ekzistencën dhe administrimin e këtij regjistri në sportelet e migracionit dhe në sektorin e migracionit dhe marrëdhënieve të punës në SHKP. Regjistri i emigrantëve në ligj është përcaktuar të jetë në MPCSSHB, ndërkohë që në SHKP është ngritur tashmë sektori i migrimit dhe marrëdhënieve të punës, i cili ka rol koordinues ndërmjet MPCSSHB dhe DRVP. Për të qenë në koherencë me funksionin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në hartimin e politikave për migracionin, në ndryshimin e nenit për regjistrin e shtetasve shqiptarë të kthyer do të bëhet dhe kalimi i regjistrimit qendror për emigrantët në SHKP. Po kështu, bashkë me kriteret e klasifikimit të shtetasve shqiptarë të kthyer në ligj, në udhëzimin për regjistrin e emigrantit do të përcaktohet edhe dokumentacioni vërtetues i emigrantit të kthyer në rastet kur ai përfiton nga shërbime specifike të parashikuara.

Ndërkohë, do të ndryshohet urdhri i MPCSSHB nr.2086, datë 13.11.2007 “Për formën, përmbajtjen e regjistrimit për emigrantët”, dhe procedurat e regjistrimit, dhe neni 12 i ligjit nr.9668/2006, për krijimin e një banke të dhënash për ruajtjen e të dhënave të shtetasve shqiptarë të kthyer dhe të regjistruar pranë sporteleve të migracionit. Këto ndryshime gjithashtu do të bëjnë të mundur lidhjen e procesit të regjistrimit të shtetasve shqiptarë të kthyer në drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të punësimit me shërbimet e informimit dhe referimit që ata do të marrin në sportelet e migracionit. Ndërkohë, regjistrimi i shtetasve shqiptarë të kthyer, të cilët do të marrin shërbime nga sportelet e migracionit, është një domosdoshmëri me qëllim vlerësimin e nevojave të tyre dhe transmetimin e tyre institucioneve përkatëse që ofrojnë shërbime të mëtejshme. Në këtë mënyrë, sportelet e migracionit do të shërbejnë si pikë kyçe në nivel vendor, për të kryer vlerësimin e nevojave të personave të kthyer, për t’u dhënë atyre informacionin që u nevojitet, si edhe për t’i referuar këta persona në institucione që japin shërbimet përkatëse.

Akte të tjera ligjore që do t’u nënshtrohen ndryshimeve me qëllimin për të bërë të mundur njohjen e këtij grupi të synuar dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse për këtë grup të synuar, në bazë të kriterëve të përcaktuara, janë:

- Programet e nxitjes së punësimit përkatësisht vendimi i Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9.2003 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papuna femra”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.48, datë 16.01.2008 “Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë ne vështirësi” i ndryshuar.
- Ndryshime në urdhrin e nr.782, datë 4.4.2006 të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta “Për tarifën e sistemit të formimit profesional” për të bërë të mundur ofrimin e trajnimeve falas në drejtoritë rajonale të formimit profesional publik të shtetasve shqiptarë të kthyer me probleme ekonomike.

Gjithashtu, për të bërë të mundur sigurimin e zgjidhjeve afatgjata të problemit të strehimit për shtetasit shqiptarë të kthyer të pastrehë, janë parashikuar ndryshime ligjore në ligjin nr.9232, datë 13.5.2004 për “Programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

Me qëllim krijimin e lehtësive për fëmijët e shtetasve shqiptarë të ripranuar, është parashikuar përfshirja në udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për fillimin e vitit të ri shkollor” të modaliteteve dhe veprimeve për t’u kryer në rastet e fëmijëve të shtetasve shqiptarë të ripranuar, si regjistrimi për herë të parë në sistemin arsimor i fëmijëve të lindur jashtë vendit, vazhdimi i studimeve të nisura jashtë vendit dhe ekuivalentimi i dëftësive dhe diplomave.


Ndryshimet ligjore do të bëjnë të mundur gjithashtu përfshirjen e kategorisë së shtetasve shqiptarë të kthyer me probleme ekonomike në grupet e veçanta të punëkërkueseve të papuna që përfitojnë nga programet e nxitjes së punësimit, më konkretisht ndryshimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9.2003.

Gjithashtu, do të sigurohet përfshirja e shtetasve shqiptarë të kthyer në skemat mbështetëse, duke filluar nga viti 2011, ku do të parashikohet që 10% e buxhetit për këto skema të planifikohet për këtë kategori.

2.2 Sigurimi i strukturave efektive dhe racionale për institucionet publike për të garantuar mbështetjen e riintegrit të shtetasve shqiptarë të kthyer

Sigurimi i strukturave efektive nënkupton funksionimin e një mekanizmi institucional (shiko fig.1) në mbështetje të riintegrit të shtetasve shqiptarë të kthyer përmes informimit dhe referimit të tyre tek strukturat dhe shërbimet përkatëse. Në përputhje me ligjin nr.9668/2006, nevojitet gjithashtu forcimi i bashkëpunimit ndërinstucional në lidhje me shtetasit shqiptarë të kthyer, sidomos për funksionimin e sistemit të referimit dhe shkëmbimin reciprok të informacionit ndërmjet sporteve të migracionit dhe gjithë institucioneve të tjera, si MB, MASH, MPTT, METE, MSH etj. dhe institucionet në varësi të tyre që do ofrojnë shërbime mbështetëse për lehtësimin e riintegrit të të kthyerve. Ky bashkëpunim do të shprehet edhe në një udhëzim të përbashkët bazuar mbi ligjin për emigrimin. Ndryshimi i ligjit duhet të përfshijë edhe sanksionimin e formës së bashkëpunimit ndërinstucional.

Figura 1. Mekanizmi i mbështetjes për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer



Njësi kyçe e këtij mekanizmi është sporteli i migracionit, një strukturë specifike që funksionon aktualisht pranë 12 drejtorive rajonale dhe 2 zyrave vendore të punësimit, nën varësinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe që do të aktivizohet në të gjitha DRP-të dhe ZVP-të. Sportelet e migracionit do të funksionojnë si pika kyçe në nivel vendor për të mbledhur të dhëna të hollësishme për shtetasit shqiptarë të kthyer që u drejtohen atyre, për të kryer vlerësimin e nevojave të tyre, për t'u ofruar informacionin e nevojshëm në përputhje me nevojat e identifikuar, si edhe për t'i referuar në institucionet përkatëse për shërbimet e kërkuara.

Mekanizmi i mbështetjes për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer reflekton gjithashtu edhe përcaktimin e indikatorëve për kategorizimin e personave që përfitojnë nga shërbimet në mbështetje të riintegrimin, parashikuar në ndryshimin e bazës ligjore ekzistuese. Ky kategorizim lehtëson konkretizimin e masave të tjera të parashikuara, si në rastin e ofrimit të tarifave preferenciale për formimin profesional, etj.

Informimi paraprak në kufi

Mekanizmi i mbështetjes për riintegrim fillon të funksionojë me mbërritjen e të kthyerve në Shqipëri. Shtetasit e kthyer, përmes marrëveshjeve të ripranimit apo formave të tjera të kthimit të detyruar, i nënshtrohen procedurës së identifikimit dhe intervistimit në PKK nga Policia Kufitare dhe e Migracionit (PKM). Për shtetasit e kthyer vullnetarisht, të cilët jo detyrimisht e deklarojnë këtë fakt gjatë hyrjes në Shqipëri, informacioni mbi sportelet e migracionit sigurohet përmes mjeteve masive vizuale të informimit në çdo pikë të kalimit kufitar (PKK) si billboard, postera, etj.

Përveç sa më sipër, Ministria e Punëve të Jashtme do të sigurojë shpërndarjen e informacionit në mbështetje të riintegrimin të shtetasve shqiptarë të kthyer në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë për të bërë të mundur marrjen e informacionit përpara kthimit në Shqipëri të tyre.

Në kuadër të këtij mekanizmi, parashikohet që informacioni paraprak mbi sportelet e migracionit dhe shërbimeve që ato ofrojnë t'u jepet shtetasve shqiptarë të kthyer pikërisht në momentin e intervistimit në pikën e kalimit të kufirit. Dhënia e informacionit paraprak për sportelet e migracionit për këtë kategori të kthyerish do të bëhet nga Policia Kufitare dhe e Migracionit, përmes një fletëpalosjeje me shpjegime dhe kontakte të sporteleve të migracionit. Kjo mënyrë referimi nga PKK tek sportelet e migracionit shmang zgjatjen e procedurës së intervistimit në PKK që do të vërehej në rast se në PKK do të kryhej një intervistë e plotë dhe vlerësim nevojash për qëllime të mbështetjes për riintegrim, që, përveç të tjerash, do të krijonte edhe mbivendosje me rolin e sporteleve të migracionit në këtë proces.

MPCSSHB do të përgatisë billboardet dhe postera për t'u vendosur në pikat e kalimit kufitar me informacion mbi sportelet e migracionit. Të gjithë shtetasit e kthyer, pas marrjes së informacionit paraprak, mund të drejtohen mbi baza vullnetare tek sportelet e migracionit.

Mbështetja për riintegrim pranë sporteleve të migracionit.

Mekanizmi parashikon një rol shumë të rëndësishëm të sporteleve të migracionit, të cilat duhet të kryejnë funksionet e mëposhtme:

1. Intervistim i shtetasve shqiptarë të kthyer që paraqiten vullnetarisht në sportel;
2. Dhënie informacioni për shërbimet publike dhe ato private, në përputhje me identifikimin e nevojave (kur ekzistojnë);
3. Referim tek shërbimet publike dhe ato private (kur ekzistojnë), si dhe projekte specifike të shoqërisë civile në përputhje me nevojat e tyre.

- Intervistimi i të kthyerve në sportelin e migracionit bëhet përmes plotësimit të pyetësorëve të hartuar për këtë qëllim nga MPCSSHB. Për të bërë të mundur ofrimin e shërbimeve në mbështetje të riintegrimin në përputhje me nevojat e shtetasve shqiptarë të kthyer do të kryhet:

- a) Shtim i infrastrukturës teknike në sportelet e migracionit;
- b) Trajnim dhe rritje kapacitetesh për intervistimin dhe referimin në sportelet e migracionit.

- Informacioni në mbështetje të riintegritit pranë sportelit të migracionit ofrohet përmes materialeve informuese të përgatitura nga institucionet përgjegjëse siç përcaktohen në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie. Çdo institucion i përfshirë në zbatimin e kësaj strategjie do të përgatisë materiale informuese të cilat do t'i dërgojë pranë MPÇSSHB. Këto materiale do të japin informacion si të hapësh një biznes në Shqipëri, ku të investosh në Shqipëri, për programet mbështetëse për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri, informacion për përkrahjen sociale, informacion për skemat e sigurimeve shoqërore, informacion mbi aksesin në sistemin shëndetësor, skemat e sigurimit shëndetësor, kushtet dhe kriteret e përfitimit, dokumentacioni dhe procedurat etj. Krahas informacionit që do t'u ofrohet direkt shtetasve shqiptarë të kthyer në sportelet e migracionit, ata do të kenë mundësi të kenë akses në këtë informacion edhe nëpërmjet faqes së internetit [www.migrantinfo.gov.al](http://www.migrantinfo.gov.al).

- Referimi i shtetasve shqiptarë të kthyer nga sportelet e migracionit tek shërbimet e tjera, në bazë të nevojave të identifikuar, në përputhje me fushën e aktivitetit të institucionit përkatës dhe programeve/nismave aktive:

- i) Referim tek Shërbimi Social Shtetëror për mbështetje psiko-sociale;
- ii) Referim në qendrat publike të formimit profesional;
- iii) Referim në institucionet arsimore në rast nevojë për arsimim të fëmijëve ose njësim diplomash;
- iv) Referim në institucionet bashkiake, në rast nevojash për strehim;
- v) Referim në institucionet përkatëse shëndetësore për të kryer procedurat për përfitimin e shërbimit shëndetësor/sigurimeve shëndetësore;
- vi) Referim në institucionet për nxitjen e biznesit (“Albinvest”, dhomat e tregtisë, sistemi bankar) në rastet kur emigrantët dëshirojnë të investojnë në vend;
- vii) Referim në strukturat përkatëse të MBUMK në rastin e shtetasve shqiptarë të kthyer nga zonat rurale, të cilët do të marrin shërbim nga skemat e subvencionimit në buqësi;
- viii) Referim në programe të shoqërisë civile për riintegrimin e të kthyerve që janë aktive në zonën ku ushtron funksionet sporteli i migracionit.

Në funksion të fuqizimit të strukturave që ofrojnë shërbime riintegrimi për të kthyerit, do të bëhet ristrukturimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të formimit profesional, duke ngritur kapacitete të Qendrës së Formimit Profesional nr.4, Tiranë, me një financim të Qeverisë Italiane (Programi i bashkëpunimit për zhvillim).<sup>7</sup>

Një element mjaft i rëndësishëm është edhe komunikimi me aktorët e shoqërisë civile që operojnë me projekte në fushën e riintegritit të shtetasve shqiptarë të kthyer. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me shoqërinë civile do të sigurohet përmes takimeve periodike dhe shkëmbimet e rregullta të informacionit në lidhje me nisma që lidhen me riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer. Për këtë qëllim, aktorët e shoqërisë civile do të caktojnë persona kontakti në këtë proces, të cilët do të ftohen rast pas rasti.

### 3. Llogaridhënia dhe monitorimi

Për llogaridhënien dhe monitorimin e kësaj strategjie dhe planit të saj të veprimit, ngarkohet Komiteti Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar, Trafiqueve dhe Terrorizmit (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.43, datë 27.1.2010). Komiteti kryesohet nga Kryeministri<sup>8</sup> dhe monitoron planin e veprimit të strategjisë së luftës kundër krimit të organizuar, trafiqueve dhe terrorizmit, si dhe strategjinë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimeve të terrorizmit. Komiteti ngarkohet të ndjekë edhe zbatimin e strategjisë së riintegritit të shtetasve shqiptarë të kthyer dhe planin e saj të veprimit, të bashkërendojë vendimmarrjen politike për çështje

<sup>7</sup> VKM Nr.334, Dt. 12.05.2010.

<sup>8</sup> Anëtarë janë Ministri i Brendshëm, Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Financave, Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror. Gjithashtu, ftohet të marrë pjesë edhe Prokurori i Përgjithshëm.



lidhur me këto strategji, si dhe për të siguruar pjesëmarrjen, sipas rastit, të ministrave përgjegjës<sup>9</sup> për zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer.

Për monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit për shtetasit shqiptarë të kthyer, Komiteti do të asistohet nga Sekretariati Teknik që do të jetë në Drejtorinë e Politikave të Migracionit, Kthimit dhe Riintegrimit në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Sekretariati teknik:

a) do të monitorojë zbatimin e masave të parashikuara në planin e veprimit të kësaj strategjie;

b) do të mbledhë çdo gjashtë muaj informacion nga institucionet shtetërore përgjegjëse të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për masat respektive që ato kanë në planin e veprimit të kësaj Strategjie; si dhe

c) do të përgatisë dy raporte në vit, përkatësisht gjashtëmuor dhe 1-vjeçar, për ecurinë e zbatimit të masave të strategjisë për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer dhe planit të saj të veprimit.

Raportet 6-mujore dhe 1-vjeçare i paraqiten Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimin të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Komiteti Ndërinstitucional diskuton për zbatueshmërinë e masave dhe problematikën e lidhur me to, si dhe merr vendime për çështje institucionale.

Institucionet përgjegjëse do të raportojnë pranë MPCSSH B mbi nivelin e zbatimit të masave në strategjinë dhe planin e veprimit për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer, problematikën e zbatimit të tyre, si dhe rekomandime për përmirësimin e situatës. Po ashtu, do të dërgohen të dhëna relevante për analizën e situatës së ofrimit të shërbimeve mbështetëse për riintegrimin e shtetasve të kthyer. Sekretariati teknik do të hartojë metodologjinë e raportimit sipas një formati të standardizuar. Progresi i ecurisë së strategjisë do të matet në bazë të disa treguesve për masat e parashikuara, të cilat janë:

- Numri i akteve ligjore të ndryshuara në afatin përkatës;
- Numri i materialeve informative të dërguara pranë përfaqësive të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit dhe numri i materialeve të tërhequra nga shtetasit shqiptarë përpara kthimit në Shqipëri;
- Numri i fletëpalosjeve dhe billbordeve në pikat e kalimit kufitar (PKK);
- Numri i trajnimeve për punonjësit e PKK;
- Numri i sporteleve të migracionit të ngritura dhe funksionale në të gjitha njësitë vendore;
- Numri i fletëpalosjeve që shpërndahen në sportelet e migracionit;
- Numri i shtetasve shqiptarë të kthyer që intervistohen nga sportelet e migracionit;
- Numri i referimeve të shtetasve shqiptarë të kthyer nga sporteli i migracionit drejt strukturave përkatëse në përputhje me nevojat dhe problematikat;
- Numri i shtetasve shqiptarë të kthyer që mbështeten me programet aktive të nxitjes së punësimit;
- Numri i shtetasve shqiptarë të kthyer mbështetur me programet e formimit profesional;
- Numri i referimeve të shtetasve shqiptarë të kthyer nga sporteli i migracionit drejt programeve aktive të riintegrimin të shtetasve shqiptarë të kthyer në zonën përkatëse (nëse ekzistojnë);
- Numri i trajnimeve për punonjësit e sporteleve të migracionit;
- Numri i trajnimeve të punonjësve socialë lidhur me shërbimet mbështetëse për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer në sistemin shëndetësor;

---

<sup>9</sup> Ministri i Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit.

- Manuali përkatës për trajnimin e punonjësve socialë lidhur me shërbimet mbështetëse për shtetasit shqiptarë të kthyer në sistemin shëndetësor, i hartuar;
- Numri i kurrikulave të përshtatura të formimit profesional publik;
- Rregullorja e DAR/ZA e miratuar me përcaktimet përkatëse për shtetasit shqiptarë të kthyer;
- Kurrikula e veçantë për mësimin plotësues të gjuhës shqipe e hartuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës përmes Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA);
- Numri i fëmijëve/nxënësve që kanë përfituar shërbim arsimor në shkollat verore ku të marrin pjesë edhe kjo kategori fëmijësh, për mësimin plotësues të gjuhës shqipe (DAR/ZA);
- Numri i fëmijëve/nxënësve që janë trajtuar nga shërbimin psikologjik i sistemit arsimor (DAR/ZA);
- Faqja e internetit [www.migrantinfo.gov.al](http://www.migrantinfo.gov.al) e përditësuar me informacionin në mbështetje të riintegrit;
- Numri i emigrantëve që janë bërë pjesë e programeve të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

## ANEKS 1 TERMINOLOGJIA

**Dëbim, deportim:** Akti i një shteti në ushtrimin e sovranitetit të tij për largimin e një të huaji nga territori i tij në një vend të caktuar pas refuzimit të qëndrimit si dhe kur i huaji nuk pranon të largohet vullnetarisht.

**Emigracion/emigrim:** Largimi apo dalja nga vendi i origjinës me qëllim sistemimin në vendin e destinacionit.

**Fluks migrantësh:** Numri i migrantëve që lëvizin ose autorizohen të lëvizin, drejt apo nga një vend për motive punësimi, apo për t'u vendosur për një periudhë të caktuar kohe.

**Imigrim (imigracion):** Hyrja nga vendi i origjinës në vendin e destinacionit me qëllim vendosjen në këtë vend.

**Kthim:** I referohet gjerësisht aktit ose procesit të kthimit nga vendi i origjinës ose tranzitit në vendin e destinacionit ose të transitit të personave të cilët nuk plotësojnë ose nuk plotësojnë më kushtet e hyrjes, tranzitimit dhe qëndrimit.

**Kthim i detyruar:** Kthimi i detyruar me forcë i një individi në vendin e origjinës, tranzitit apo në një vend të tretë, mbi bazën e një akti administrativ apo gjyqësor.

**Kthim vullnetar:** Kthimi i asistuar ose i pavarur në vendin e origjinës, tranzitit ose në një vend të tretë në bazë të vullnetit të lirë të të kthyerit ose në zbatim të një urdhri largimi vullnetar.

**Migrant:** Personi i cili lëviz nga një vend origjine në një vend destinacioni me qëllim vendosjen në këtë vend.

**Migrant i parregullt:** Personi, i cili ka hyrë ose qëndron në mënyrë të paligjshëm në një vend destinacioni apo tranzit.

**Migram, migracion:** Procesi i lëvizjes së personave që përfshin kalimin e një kufiri ndërkombëtar.

**Migram (migracion) i parregullt:** Lëvizja që kryhet jashtë normave ligjore rregulluese të vendeve të origjinës, të tranzitit dhe të destinacionit.

**Migrimi (migracioni) për motive punësimi:** Lëvizja e njerëzve nga vendi i origjinës në një vend tjetër për motive punësimi.

**Migrimi (migracion) i kthimit:** Lëvizja e një personi që kthehet në vendin e tij/saj të origjinës ose të vendbanimit të zakonshëm zakonisht pasi kalon të paktën një vit në një vend tjetër. Ky kthim mund të jetë vullnetar ose jo. Migrimi i kthimit përfshin edhe riatdhesimin vullnetar. Emigrant i kthyer në kontekstin e këtij dokumenti u referohet shtetasve shqiptarë të kthyer nga emigracioni përmes formave të ndryshme të kthimit, të detyruara ose vullnetare.

Marrëveshje ripranimi: Aktet dy ose shumëpalëshe të arritura me qëllim bashkëpunimin për të luftuar migracionin e paligjshëm nëpërmjet përcaktimit të kriterëve, procedurave sa më të thjeshtësuara në bazë të të cilave një shtet mund të kthejë të huajt në gjendje të parregullt në shtetin e tyre ose në një shtet tjetër përmes të cilit ata kanë kaluar gjatë udhëtimit drejt shtetit që kërkon t'i kthejë ata.

Riintegrim: Ripërfshirje apo ritrupëzimi i një personi në një grup ose proces, p.sh. një migrant në shoqërinë e vendit të tij të origjinës.

Riintegrim (kulturor): Ripërshtatje e migrantit të kthyer me vlerat, mënyrën e jetesës, gjuhën, parimet morale, ideologjisë dhe traditave të shoqërisë së vendit të origjinës.

Riintegrim (ekonomik): Ripërfshirje e një migranti në sistemin ekonomik të vendit të tij/saj të origjinës. Migrantit duhet t'i ofrohet mundësia të fitojë vetë jetesën. Në terma të zhvillimit, riintegrimi ekonomik synon edhe shfrytëzimin e njohurive që ka marrë në vendin e huaj për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit të origjinës.

Riintegrim (shoqëror): Ripërfshirje e një migranti në strukturat shoqërore të vendit të tij/saj të origjinës. Kjo përfshin nga njëra anë krijimin e një rrjeti personal (miq, të afërm, fqinjë) dhe nga ana tjetër zhvillimin e strukturave të shoqërisë civile (shoqata, grupe të vetëmbështetjes dhe organizata të tjera).

Ripranim : Transferimi i një personi nga vendi kërkues në vendin pritës, në bazë të kërkesës dhe pa formalitete të tjera, përveç atyre të përcaktuara në marrëveshje ripranimi apo protokolle zbatimi.

PLANI I VEPRIMIT

Nr.	A. PËRMIRËSIMI I KUADRIT LIGJOR PËR MBËSHTETJEN E RIINTEGRIMIT					
	Objektivat	Masat	Institucionet Përgjegjëse / Burimet Njerëzore	Institucionet Bashkëpunuese	Afati i Realizimit	Burimet e Zbatimit (lekë / Euro)
1.	Përmirësimi i bazës ligjore ekzistuese në lidhje me mbështetjen për riintegrim	Ndryshim i ligjit 9668/2006 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, neni 2, pika 14, për përkufizimin e emigrantit të kthyer, neni 13 mbi “Statusin e emigrantit” dhe neni 8 pika 1 “E drejta për të përfituar nga shërbimet shtetërore”.	MPÇSSHB (DPMKR, DSHJ) / 4 persona	MPJ, MD, MB METE, MASH, MF, MBUMK,	2010 (Nëntor)	Kosto administrative
2.		Ndryshim i urdhrin nr.1722, datë 18.9.2007 “Për formën, përmbajtjen e dokumentit dhe procedurën e përfitimit të statusit të emigrantit”.	MPÇSSHB (DPMKR, DSHJ) / 3 persona	MPJ, MD	2010 (Dhjetor)	Kosto administrative
3.		Ndryshimi i urdhrin të Ministrit të Punës nr.2086, datë 13.11.2007 “Për formën, përmbajtjen e “Regjistrin për emigrantët”, dhe procedurat e regjistrimit”, bazuar në nenin 104 pika 4 të Kushtetutës dhe nenin 12 të ligjit 9668/2006, për krijimin e një banke të dhënash për ruajtjen e të dhënave të shtetasve shqiptarë të kthyer dhe të regjistruar pranë sporteve të migracionit.	MPÇSSHB (DPMKR, DSHJ) / 3 persona		2010 (Dhjetor)	Kosto administrative
4.		Përfshirja e kategorisë së shtetasve shqiptarë të kthyer me probleme ekonomike, në grupet e veçanta të punëkërkuessve të papunë që përfitojnë nga programet e nxitjes së punësimit. Më konkretisht:	MPÇSSHB (DSHJ, DPP) / 5 persona		2010 (Nëntor)	Kosto administrative
		Ndryshimi në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.632 datë 18.9.2003 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuessve të papunë femra” (ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.508, datë 8.08.2007)				

		Ndryshimi në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.48, datë 16.1.2008 “Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë në vështirësi (ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.991, datë 2.7.2008).				
5.		Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve përkatëse në urdhrin nr.782, datë 4.4.2006 (i ndryshuar) të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta “Për tarifën e sistemit të formimit profesional” për të bërë të mundur ofrimin e trajnimeve falas në drejtoritë rajonale të formimit profesional publik të shtetasve shqiptarë të kthyer me probleme ekonomike.	MPÇSSHB (DSHJ, DPP) / 3 persona			2010 (Shtator)  Kosto administrative
6.		Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, për të bërë të mundur sigurimin e zgjidhjeve afatgjata të problemit të strehimit për shtetasit shqiptarë të kthyer të pastrehë, nëpërmjet programeve sociale të strehimit.  Ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.53/2005, mbi dokumentacionin që duhet të plotësojnë emigrantët e kthyer për të aplikuar për strehim.	MPPTT  MPPTT	MF, MD, MPCSSHB		Qershor 2011 (Dërgimi për miratim)  3 muaj pas miratimit të ndryshimeve në ligj  Kosto administrative
7.		Përfshirja në udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për fillimin e vitit të ri shkollor” e modaliteteve dhe veprimeve për t’u kryer në rastet e fëmijëve të shtetasve shqiptarë të ripranuar: a) regjistrimi për herë të parë në sistemin arsimor i fëmijëve të lindur jashtë vendit b) vazhdimi i studimeve të nisura jashtë vendit; c) ekuivalentimi i dëftësive dhe diplomave.	MASH			2010  Kosto administrative
8.		Ndryshim i vendimit të Këshillit të Ministrave vjetor për skemat mbështetëse.	MBUMK			2011-2015  Kosto administrative
9.		Ndryshim i udhëzimit të përbashkët vjetor i MBUMK e MF.	MBUMK			2011-2015  Kosto administrative

Nr	B. Sigurimi i strukturave efektive dhe racionale për institucionet publike për të garantuar mbështetjen e riintegrit të shtetasve shqiptarë të kthyer					
10.	Krijimi dhe përmirësimi i kuadrit institucional për mbështetjen e riintegrit të shtetasve shqiptarë të kthyer	Ngritja e “Sporteve të migracionit” në 22 zyra vendore të punësimit.	MPÇSSHB, SHKP / 25 persona		2010 Qershor - korrik	2.200.000 lekë / 16.090 euro
11.		Shpërndarja e informacionit për riintegrimin e të kthyerve në pikat e kalimit të kufirit dhe gjatë intervistimit të personave të ripranuar nga vendet e tjera	MB, DPP, DKM / personeli në 17 PKK ku bëhen ripranimet	Të gjitha institucionet e përfshira në përgatitjen e materialeve informuese	Korrik 2010-2015	Kosto administrative
12.		Përmirësimi i bashkëpunimit me autoritetet shtetërore përgjegjëse që përfshihen në këtë strategji me qëllim shkëmbimin e informacionit të nevojshëm. - vendosja e pikave të kontaktit me çdo autoritet shtetëror përgjegjës - organizimi i takimeve periodike. - shkëmbimi i informacionit periodik, për rastet e kthimeve.	MPÇSSHB / 4 persona	Të gjitha institucionet e përfshira	2010-2015  Korrik 2010  Çdo 6 muaj  Çdo 3 muaj	Kosto administrative
13.	Rritja e kapaciteteve të strukturave që merren me riintegrimin e të kthyerve në Shqipëri	Trajnim i personelit të sporteve të migracionit për intervistimin, identifikimin e nevojave, dhënien e informacionit dhe referimit për shtetasit shqiptarë të kthyer.	MPÇSSHB, ITAP / 39 persona	Donatorë	2010-2015:  2 herë në vit	300.000 lekë në vit / 2.195 euro në vit
14.		Plotësimi i kushteve në PKK të miratuara përripranimin e shtetasve që kthehen nga policitë e vendeve të tjera, për akomodimin, intervistimin e tyre.	MB, DPP, DKM, MF, DPD		Qershor 2010 – dhjetor 2011	Në kuadër të programit CARDS 2004, “Mbështetje për Policinë Kufitare dhe doganat”, 3.500.000 euro

15.		Sigurimi i transportit të të kthyerve nga PKK deri në qendrat me të afërta urbane, si edhe për grupet vulnerabël deri në qendrat më të afërta të banimit	MB, DPP, DKM, DRKM		2010 - 2015	Kosto për kontraktimin e mjeteve të transportit me kapacitet mbi 50 vende për 3 PKK  25.000 lekë / rrugë x 365 ditë x 3 PKK = 27.375.000 lekë në vit x 5 vjet 136.875.000 lekë ose 98.000 euro
16.		Sigurimi i nevojave me ushqim, ujë dhe medikamente për të kthyerit në PKK.	MB, DPP, DKM, DRKM		2010 - 2015	Kosto për trajtim me ushqim & medikamente  (60 000 të kthyer në vit) kosto e trajtimit vjetore  60 milion lekë / 428.600 euro
17.		Zgjerimi i veprimtarisë dhe problematikave të trajtuara në Seminarin e përvitshëm për mësuesit, duke synuar rritjen e aftësisë në përgjigje të një plani afatgjatë për riintegrimin e personave të ripranuar.	MASH		2011-2015	Parashikuar PBA 2011-2013, në programin buxhetor të arsimit bazë dhe arsimit të mesëm: 3.200.000 lekë në 4 vjet / 22.857 euro në 4 vjet

Nr.	C. Integrimi i shtetasve shqiptarë të kthyer në jetën ekonomike dhe sociale të vendit përmes ofrimit të informacionit, referimit dhe shërbimeve të drejtpërdrejta					
	Objektivat	Masat	Institucionet Përgjegjëse / Burimet njerëzore	Institucionet Bashkëpunuese	Afati i Realizimit	Burimet e Zbatimit (lekë / euro)
18.	Mbështetja e riintegritimit ekonomik të shtetasve shqiptarë të kthyer në Shqipëri përmes informacionit	Përgatitja dhe prodhimi i fletëpalosjeve me informacion orientues për të kthyerit lidhur me sportelet e migracionit dhe kontaktet e tyre, për t'u shpërndarë tek shtetasit shqiptarë të kthyer në PKK.	MPÇSSHB (DPMKR, DSHJ) / 4 persona	MPPT, MF, MSH, METE, MBUMK, MB	2010-2015 (përditësimi i vazhdueshëm sipas nevojës)	900.000 lekë në vit / 6.445 euro në vit  60.000 fletëpalosje në vit
19.		Përgatitje posterash për t'u vendosur në pikat e kalimit të kufirit.	MPÇSSHB (DPMKR, DSHJ) / 4 persona		2010 -2015 (përditësimi i vazhdueshëm sipas nevojës)	1.100.000 lekë në vit / 8.047 euro në vit
21.		Botimi i fletëpalosjeve me informacion: - “Si të hapësh një biznes në Shqipëri” - “Ku të investosh në Shqipëri” - “ Programe mbështetëse për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri - Informacion për përkrahjen sociale - Informacion për skemat e sigurimeve shoqërore - Informacion mbi aksesin në sistemin shëndetësor, skemat e sigurimit shëndetësor, kushtet dhe kriteret e përfitimit, dokumentacioni dhe procedurat	MPÇSSHB, MPPT, MF, MSH, METE, MBUMK, MB / 3 persona		Qershor 2010 e në vazhdim	Kosto për botimin  = 4.100.000 lekë në vit / 29.995 euro në vit
22.		Shpërndarje informacioni mbi mundësitë e kreditimit për shtetasit shqiptarë të kthyer në kuadër të Programit të Zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme Itali-Shqipëri.	METE, Njësia e Menaxhimit të Programit Italian		2010 - 2015	5000 fletëpalosje me kosto 1500 euro
23.		Shpërndarja e informacionit të parashikuar në Planveprim nëpër Përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë të akredituara jashtë vendit.	MPJ / personeli i ambasadave		2010-2015	Kosto administrative
24.		Pasqyrimi në faqen e internetit <a href="http://www.mpcs.gov.al">www.mpcs.gov.al</a> dhe <a href="http://www.migrantinfo.gov.al">www.migrantinfo.gov.al</a> të gjithë informacionit të hartuar për mbështetjen e riintegritimit shtetasve shqiptarë të kthyer.	MPÇSSHB / 2 persona		2010 (Qershor)	Kosto administrative



25.	<b>Mbështetja e riintegritit ekonomik të shtetasve shqiptarë të kthyer përmes programeve të nxitjes së punësimit</b>	Përfshirja e emigrantëve të kthyer, me probleme ekonomike, që plotësojnë kriteret e përcaktuara, në programet e nxitjes së punësimit. Konkretisht: i) programi i nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë femra; ii) programi i nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë në vështirësi; iii) programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë; dhe iv) programi i praktikave profesionale	MPÇSSHB, SHKP / 8 persona		<b>2010 - 2015</b>	2010 Kosto administrative  2011 6.6 milion lekë / 48.284 euro  2012 7.2 milion lekë / 52.675 euro  2013 9.2 milion lekë / 67.306 euro  2014 10.5 milion lekë / 76.816 euro  2015 11.8 milion lekë / 86.327 euro
26.		Identifikimi i nevojave ekzistuese për formimin profesional të shtetasve shqiptarë të kthyer.	MPÇSSHB, SHKP / 40 persona		<b>2010-2011</b>	Kosto administrative
27.	<b>Mbështetja e riintegritit ekonomik të shtetasve shqiptarë të kthyer përmes përfshirjes në kurset publike të formimit profesional</b>	- Pjesëmarrje e emigrantëve të kthyer me probleme ekonomike që plotësojnë kriteret e përcaktuara, në kurse publike të formimit profesional me tarifa falas.  - Përshtatja e kurrikulave ekzistuese.	MPÇSSHB, SHKP / 20 persona		<b>2010-2015</b>	Kosto 19 milion lekë në vit / 139.000 euro në vit  Kostoja për kurrikula 1milion lekë / 7.316 euro
28.		Fuqizim i kapaciteteve të formimit profesional nëpërmjet rikonstruksionit dhe fuqizimit të Qendrës së Formimit Profesional nr.4, Tiranë.	MPÇSSHB / 15 persona		<b>2010-2012</b>	Kosto prej 2.050.000 lekë / 1.5 milion euro. Qeveria italiane

29.	<b>Mbështetja e riintegrit të shtetasve shqiptarë të kthyer në Shqipëri në sistemin arsimor të përgjithshëm dhe profesional, përmes informacionit dhe shërbimeve</b>	Përcaktimi në rregulloren e funksionimit të drejtorive arsimore rajonale (DAR) dhe zyrave arsimore (ZA) i detyrave për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer dhe modaliteteve të bashkëpunimit me të gjitha institucionet lokale që veprojnë në ndihmë të këtyre shtetasve.	MASH, DAR/ZA		<b>2010</b>	Kosto administrative
30.		Hartimi i kurrikulës së veçantë për mësimin plotësues të gjuhës shqipe nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës përmes Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA). Gjatë këtij procesi do të mbahen parasysh diferencat e mundshme të shkollës jashtë vendit, në vendet kryesore të destinacionit të emigrantëve shqiptarë, me programet që ofron sistemi arsimor shqiptar.	MASH (IZHA)		<b>2010 - 2012</b>	Parashikuar në PBA 2011-2013, programi buxhetor, arsimit bazë dhe arsimit i mesëm: 400.000 lekë në 4 vjet / 2900 euro në 4 vjet
31.		Organizimi i shkollave verore ku të marrin pjesë edhe kjo kategori fëmijësh, për mësimin plotësues të gjuhës shqipe.	MASH, DAR/ZA		<b>2011-2015</b>	Parashikuar në PBA 2011-2013 në programin buxhetor, arsimit bazë dhe arsimit i mesëm: 20.970.000 lekë në 4 vjet / 151.957 euro në 4 vjet
32.		Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore, në planin vjetor të punës të përfshijnë shprehimisht detyrat e mëposhtme: a) Sektori i statistikës evidenton dhe raporton periodikisht në MASH për ardhjen dhe sistemimin në institucionet e arsimit parauniversitar të fëmijëve të shtetasve shqiptarë të ripranuar; b) Sektori i kurrikulave dhe Cilësisë do të ketë të gatshme programet mësimore në ndihmë të këtyre fëmijëve duke evidentuar të gjitha nevojat sipas grupmohave;	MASH, DAR/ZA, IZHA		<b>2010-2015</b>	Parashikuar në PBA 2011-2013 në programin buxhetor, arsimit bazë dhe arsimit i mesëm:  b) 600.000 lekë në 4 vjet / 4350 euro në 4 vjet

		c) Sektori i kurrikulave dhe cilësisë bashkëpunon me IZHA e OJF të specializuara të cilat ofrojnë programe trajnimi për këtë kategori nxënësish.				
33.		AKAFP në bashkëpunim me institucione të specializuar vendase dhe të huaja, të bëjë përshtatjen e politikave kurrikulare me nevojat e të kthyerve për arsimim dhe formim profesional.	MASH, AKAFP		2011-2015	Parashikuar në PBA 2011-2013  2.200.000 lekë / 15.942 euro
34 .	Mbështetja e riintegrit të shtetasve shqiptarë të kthyer në Shqipëri në sistemin shëndetësor, sigurimeve shëndetësore dhe mbrojtjes sociale	Orientim përmes punonjësve socialë në drejtoritë e shëndetit publik. Trajnimi i punonjësve socialë lidhur me shërbimet ndaj shtetasve shqiptarë të kthyer. Përgatitja e manualit përkatës.	MSH, ISKSH		2011-2015  2 trajnime në vit  2011 – manuali i trajnimit	Kosto e trajnimeve: 708.000 leke në vit / 5.057 euro në vit  Kosto e manualit: 500.000 lekë / 3.571 euro
35.		Informim dhe ofrim i imunizimit dhe profilaksisë sipas historisë së udhëtimeve dhe gjeografisë së qëndrimit dhe udhëtimit.	MSH, ISKSH		2010  (përditësim i vazhdueshëm sipas nevojës)	Kosto e ofrimit të shërbimit do të jetë kosto administrative.  Kosto e informimit të shënjestruar përmes fletëpalosjeve:  900.000 lekë në vit / 6.445 euro në vit  60.000 fletëpalosje në vit
36.		Informimi, analiza dhe dhënia e përfitimit shtetasve shqiptarë të kthyer të pagesave në para në dorë dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror në njësitë e qeverisjes vendore.	MPÇSSHB, SHSSH, Njësitë e qeverisjes vendore / 390 persona		2010-2015	570.000.000 lekë në vit/ 4.170.020 euro në vit.

37.	Mbështetja e riintegrit të shtetasve shqiptarë të kthyer përmes ofrimit të mbështetjes psiko-sociale për rastet kur nevojitet	Ofrimi i shërbimit psikologjik të sistemit arsimor ndaj fëmijëve të kthyer në përshtatshmërinë e tyre me shkollën, në marrëdhëniet mes komunitetit të nxënësve, si dhe në marrëdhëniet mes tyre dhe personelit mësimdhënës.	MASH, DAR/ZA		2010-2015	Parashikuar në PBA 2011-2013, programi buxhetor, arsimit bazë dhe arsimit i mesëm: 2.097.000 lekë në 4 vjet / 15.196 Euro në 4 vjet
38.	Mbështetja e riintegrit të shtetasve shqiptarë të kthyer përmes ofrimit të informacionit mbi programet vendore të strehimit; lehtësimi dhe shpejtimi i zgjidhjes së përkohshme për rastet më problematike dhe emergjente dhe sigurimi i zgjidhjeve afatgjata nëpërmjet programeve sociale të strehimit	- Ndryshime në ligjin nr. 9232, datë 13.05.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", i ndryshuar, me synim zgjidhjet e përkohshme për raste emergjente.  - Planifikimi i fondeve për bonusin e strehimit për rreth 50 familje/persona	MPTT  MPPTT, në bashkëpunim me MF	MD, MF, MB, njësitë e qeverisjes vendore	Qershor 2011 (dërgimi për miratim në KM -	Kosto administrative  Faza e dytë e PBA: 4.500.000 lekë / 34.000 euro
39.	Mbështetja e riintegrit të shtetasve shqiptarë të kthyer nga zonat rurale, përmes programeve për nxitjen e investimeve në bujqësi	Sigurimi i informacionit të nevojshëm për shtetasit shqiptarë të kthyer mbi programet vendore të strehimit, në koordinim me institucionet e tjera dhe njësitë vendore: 1. Përgatitja e informacionit e rreth 160.000 fletëpalosjeve; 2. Koordinimi me institucionet e tjera për përfshirjen e informacionit nëpër fletëpalosje; 3. Informimi i nevojshëm për njësitë vendore	MPPTT	MPÇSSH dhe Bashkitë	2010 (përditësimi i vazhdueshëm sipas nevojës) 1. Mars 2011 2. Mars Qershor 2011 3. Qershor 2011 e në vijim	Parashikuar në PBA 2011-2013:  2.000.400 lekë në vit / 15.000 euro në vit
40.	Mbështetja e riintegrit të shtetasve shqiptarë të kthyer nga zonat rurale, përmes programeve për nxitjen e investimeve në bujqësi	Përfshirja e shtetasve shqiptarë të kthyer nga zonat rurale në programet për nxitjen e investimeve në sektorin e bujqësisë, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	MBUMK	MF	2011-2015	Kosto administrative

41.	<b>Mbështetja e riintegrit të shtetasve shqiptarë të kthyer përmes bashkëpunimit me shoqërinë civile.</b>	Krijimi i një data-base, pranë sporteve të migracionit mbi projektet të cilat aplikohen nga organizatat lokale dhe ndërkombëtare, në qarkun përkatës, për shtetasit shqiptarë të kthyer.	SHKP / 38 persona		<b>2010-2015</b>	Kosto administrative
42.		Orientimi i shtetasve shqiptarë të kthyer drejt organizatave lokale dhe ndërkombëtare që trajtojnë problemet e tyre.	SHKP / 36 persona		<b>2010-2015</b>	Kosto administrative

**VENDIM**  
**Nr.478, datë 16.6.2010**

**PËR NDËRPRERJEN E MARRËDHËNIEVE TË PUNËS, NGA ORGANET E  
ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PAS PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE PËR PENSION  
PLEQËRIE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 31, pika 1, dhe 33 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 21 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, si dhe të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ky vendim rregullon procedurat që do të ndiqen nga organet e administratës shtetërore, të financuara tërësisht apo pjesërisht nga Buxheti i Shtetit, në rastet e plotësimit, nga ana e nëpunësit/punonjësit të siguar, të kushteve për pension pleqërie, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Institucione të administratës shtetërore, në kuptim të këtij vendimi, janë institucionet qendrore, institucionet e varësisë, si dhe ndërmarrjet e shoqëritë tregtare shtetërore.

3. Përfshihen nga zbatimi i këtij vendimi të gjitha subjektet dhe individët që, pavarësisht objektit të veprimtarisë, ushtrojnë veprimtari private.

4. Organet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, me plotësimin e kushteve për pension pleqërie, sipas dispozitave të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ndërpresin menjëherë marrëdhëniet e punës për këtë kategori nëpunësish/punonjësish.

5. Nëpunësit/punonjësit, marrëdhënia e punës e të cilëve ndërpritet në zbatimin e këtij vendimi, gëzojnë të gjitha të drejtat për përfitimin e pensionit të pleqërisë, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.

6. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.522, datë 30.6.2010**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA SHPRONËSIMI PËR QËLLIM TË NDËRTIMIT, PRONËSISË, SHFRYTËZIMIT, MIRËMBAJTJES DHE TRANSFERIMIT NË FAVOR TË SHTETIT TË PROJEKTIT TË NJË HIDROCENTRALI TË RI NË ASHTË, NË QARKUN E SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga shpronësimi për qëllim të ndërtimit, pronësisë, shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe transferimit në favor të shtetit të projektit të një hidrocentrali të ri në Ashtë, në qarkun Shkodër, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të shoqërisë “Energji Ashta”, sh.p.k.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 53 534 (pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) m<sup>2</sup>, tokë, arë, truall, ullishte, pemëtoje, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 43 849 002 (dyzet e tre milionë e tetëqind e dyzet e nëntë mijë e dy) lekë.

4. Fondi prej 43 849 002 (dyzet e tre milionë e tetëqind e dyzet e nëntë mijë e dy) lekësh të përballohet nga fondet e shoqërisë “Energji Ashta”, sh.p.k.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit, në shumën 1 131 000 (një milion e njëqind e tridhjetë e një mijë) lekë, të përballohet nga shoqëria “Energji Ashta”, sh.p.k., si subjekt kërkues i këtij shpronësimi.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda vitit 2010.

7. Mënyra e pagesës të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”.

8. Punimet për qëllim të ndërtimit, pronësisë, shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe transferimit në favor të shtetit të projektit të një hidrocentrali të ri në Ashtë, në qarkun Shkodër të përfundojë brenda 40 muajve nga data e fillimit të punimeve të ndërtimit.

9. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqëria “Energji Ashta”, sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES

LISTA E PRONARËVE PËR SHPRONËSIM PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË HIDROCENTRALIT TË ASHTËS  
TABELA PËRMBLEDHËSE PËR QARKUN SHKODËR

nr	Objekti	Shpronësimi definitiv						Te mbjellat e demtuara			Vlera totale e kompensimit	SHENIME	
		Njesia e qeverisjes vendore	Zona Kadastrale	Lloji i pronës	Sipërfaqja e pronës m <sup>2</sup>	Sipërfaqja e shpronësimit	Lekë/m <sup>2</sup>	Vlera e kompensimit	Sipërfaqja	Lloji i te mbjellave			Vlera e te mbjellave
1	Sheshi	Komuna Bushat	2236	Toke are	9,890	9,106	404	3,678,824			106,250	3,785,074	
		Bashkia Vau i Dejës	3498	truall	n/a	377	990	373,230				373,230	
2	Rezervuari	Bashkia Vau i Dejës	1466	Toke are (vreshta, peme frutore, etj)	30,726	12,883	399	5,140,317			5,227,660	10,367,977	
				truall	18,665	6,851	2121	14,530,971			2,671,700	17,202,671	
			3498	Toke are (vreshta, peme frutore, etj)	9,301	8,045	314	2,526,130			2,090,440	4,616,570	
				Truall	3,740	1,272	990	1,259,280			49,200	1,308,480	
			2702	Arë	15,000	15,000	413	6,195,000			0	6,195,000	
					53,534		33,703,752			10,145,250			

43.849.002 Vlera totale e kompensimit

Gjithashtu për realizimin e këtyre procedurave janë kryer shpenzime procedurale, të cilat janë ngarkim të subjektit kërkues, shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. dhe konsistojnë në:

1. Publikimi në dy gazeta me shpërndarje kombëtare në gazetën “Sot” dhe në gazetën “Panorama” për një periudhë njëjavore për çdo publikim të cilat kapin vlerën totale prej 1 106 000 (një milion e njëqind e gjashtë mijë) lekë.
2. Bazuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.126, datë 23.3.2000 “Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të komisionit të posaçëm të shpronësimit” është parashikuar një masë shpërblymi për pesë anëtarët e komisionit të posaçëm të shpronësimit, në vlerë totale prej 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

Qarku Shkodër  
Komuna Bushat

Lloji i pasurisë që shpronësohet: Arë, Truall

Lloji i pasurisë që dëmtohet për shkak të ndërtimit: Kultura bujqësore, të mbjella

Nr	Objekti	Shpronësim Definitiv										Shpronësim provizor					Vlera totale e kompensimit	Adresa e pronarit	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i Pasurisë	Z.K	Nr. Pasurisë	Sip. e Pasurisë (m <sup>2</sup> )	Sip. shpronësim definitiv (m <sup>2</sup> )	Çmimi lekë/m <sup>2</sup>	Vlera e kompensimit (Lekë)	Sasia në m <sup>2</sup>	Lloji i kulturës	Vlera Lekë/kg	Sasia (Kv/Kg)	Vlera e kompensimit (lekë)			
1	Ashta HPP	JUP	SMAJL	MUSTAFA	Arë	2236	18/1	2,080	2,287	404	923,948.00	djerrë	djerrë	djerrë	djerrë	0.00	923,948.00	Kosmaç	Certifikata dt. 16.12.2008
2	Ashta HPP	SHEFIK	SHAQIR	GAVOCI	Arë	2236	18/2	3,470	3,205	404	1,294,820.00	300/800	pras/lolium	35/5	7.5/16000	106,250.00	1,401,070.00	Kosmaç	Certifikata dt. 17.03.1999
3	Ashta HPP	HASHIM	OSO	MLLOJA	Arë	2236	18/3	4,340	3,614	404	1,460,056.00	djerrë	djerrë	djerrë	djerrë	0.00	1,460,056.00	Kosmaç	Certifikata dt. 25.10.2006
	Ashta HPP	VELI	OSO	MLLOJA						404								Kosmaç	
	Ashta HPP	HYSEN	XHEMAL	RJOLLI						404								Kosmaç	
	Ashta HPP	NADIR	ALI	ALIAJ						404								Kosmaç	
4	Ashta HPP	BEQIR	ALI	ZENELI	Truall	3498	168/1		377	990	373,230.00	-	-	-	-	0.00	373,230.00	Spatharë	
		<b>Shuma në m<sup>2</sup></b>										<b>Shuma në Lekë</b>					<b>4,158,304.00</b>		



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

LISTA E PRONARËVE NË RRJEDHËN E SIPËRME TË LUMIT DRIN, QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË NJË HIDROCENTRALI TË RI NË ASHTË, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Qarku Shkodër

Bashkia Vau i Dejes

Lloji i pasurisë që shpronësohet: arë, truall, pemëtoje, ullishte

Lloji i pasurisë që dëmtohet për shkak të ndërtimit: Kultura bujqësore, të mbjella

Nr	Objekti	Shpronësim Definitiv									Shpronësim provizor					Vlera totale e kompensimit	Adresa e pronarit	Shënime	
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i Pasurisë	Z.K	Nr. Pasurisë	Sip. e Pasurisë (m2)	Sip. shpronësim definitiv (m2)	Çmimi lekë/m2	Vlera e kompensimit (Lekë)	Sasi a në m2	Lloji i kulturës	Vlera lekë/kg	Sasia (Kv/Kg)				Vlera e kompensimit (lekë)
1	Ashta HPP	Agim	Muhamet	Golemi	PEMETORE	1466	47/4	1,594	702	399	280,098.00	-	hardhi, sheg, etj	-	-	211,160	491,258.00	VAU DEJAS	
2	Ashta HPP	Agim	Shefqet	Agjia	PEMETORE+TRUALL	1466	56/4	2,750	16	2121	33,936.00	-	-	-	-	0	33,936.00	VAU DEJAS	
3	Ashta HPP	Dod	Zef	Caka	ULLISHTE	3498	109/3	356	356	314	111,784.00	-	fiq, hardhi, etj	-	-	45,600	157,384.00	SPATHAR	
4	Ashta HPP	Ejell	Mark	Preci	ARE	3498	108/3	149	149	314	46,786.00	-	hardhi, fiq, etj	-	-	182,300	229,086.00	SPATHAR	
5	Ashta HPP	Enver	Shefqet	Agjia	PEMETORE	1466	49/7	1,380	134	399	53,466.00	-	hardhi, pjeshke	-	-	142,000	195,466.00	VAU DEJAS	
6	Ashta HPP	Frano	Dede	Zefi	ARE+TRUALL	3498	133	1,562	737	990	729,630.00	-	fiq	-	-	20,500	750,130.00	SPATHAR	
7	Ashta HPP	Gjon	Zef	Deja	ARE	1466	52/3	610	610	399	243,390.00	-	hardhi,miser,etj	-	-	396,300	639,690.00	VAU DEJAS	
8	Ashta HPP	Hile	Lazer	Nika	PEMETORE+TRUALL	1466	385/31	6,550	934	2121	1,981,014.00	-	-	-	-	0	1,981,014.00	VAU DEJAS	
9	Ashta HPP	Jak	Lazer	Ndoci	ARE	3498	109/1	288	288	314	90,432.00	-	pjeshke, sheg, etj	-	-	59,800	150,232.00	SPATHAR	
10	Ashta HPP	Jak	Lazer	Ndoci	ARE	3498	108/6	418	418	314	131,252.00	-	hardhi, fiq, etj	-	-	215,600	346,852.00	SPATHAR	
11	Ashta HPP	Shtjefen	Gjergj	Preci	ARE	3498	108/1	450	450	314	141,300.00	-	kumbll, hardhi, etj	-	-	171,940	313,240.00	SPATHAR	
12	Ashta HPP	Jak	Lazer	Ndoci	ARE	3498	108/4	195	195	314	61,230.00	-	hardhi, fiq, etj	-	-	10,200	71,430.00	SPATHAR	
13	Ashta HPP	Jak	Gjergj	Deja	ARE	1466	52/4	500	500	399	199,500.00	-	hardhi, jonxh, etj	-	-	1,471,300	1,670,800.00	VAU DEJAS	
14	Ashta HPP	Lazer	Dod	Prenci	ULLISHTE	3498	107/1	1,300	1,000	314	314,000.00	-	-	-	-	0	314,000.00	SPATHAR	
15	Ashta HPP	Loro	Pjeter	Caka	PEMETORE	3498	134	480	55	314	17,270.00	-	-	-	-	0	17,270.00	SPATHAR	
16	Ashta HPP	Loro	Dod	Preci	ARE	3498	109/7	1,200	1,200	314	376,800.00	-	-	-	-	0	376,800.00	SPATHAR	
17	Ashta HPP	Loro	Pjeter	Caka	PEMETORE	3498	105/6	442	269	314	84,466.00	-	-	-	-	0	84,466.00	SPATHAR	
18	Ashta HPP	Ludovik	Gaspar	Deja	PEMETORE+TRUALL	1466	50/1	1,100	101	2121	214,221.00	-	-	-	-	0	214,221.00	VAU DEJAS	
19	Ashta HPP	Mark	Ndoc	Ndoci	ULLISHTE+TRUALL	3498	130/1	1,940	297	990	294,030.00	-	-	-	-	0	294,030.00	SPATHAR	
20	Ashta HPP	Mark	Ndoc	Ndoci	ULLISHTE	3498	129/1	1,035	1,035	314	324,990.00	-	hardhi	-	-	700,000	1,024,990.00	SPATHAR	
21	Ashta HPP	Martin	Gjergj	Deja	PEMETORE+TRUALL	1466	51/1	1,550	694	2121	1,471,974.00	-	hardhi, ara, etj	-	-	1,087,000	2,558,974.00	VAU DEJAS	
22	Ashta HPP	Ndue	Gaspar	Deja	PEMETORE	1466	52/2	2,100	2,100	399	837,900.00	-	hardhi, fiq, etj	-	-	1,171,200	2,009,100.00	VAU DEJAS	
23	Ashta HPP	Pashuk	Ndreke	Deja	ARE+TRUALL	1466	52/5	4,375	4,375	2121	9,279,375.00	-	hardhi, fiq, etj	-	-	1,185,700	10,465,075.00	VAU DEJAS	
24	Ashta HPP	Rrok	Zef	Caka	ARE	3498	109/2	332	332	314	104,248.00	-	hardhi, fas, etj	-	-	26,200	130,448.00	SPATHAR	
25	Ashta HPP	Rrok	Zef	Caka	PEMETORE	3498	105/4	392	183	314	57,462.00	-	-	-	-	0	57,462.00	SPATHAR	
26	Ashta HPP	Rrok	Zef	Caka	TRUALL	3498	105/3	238	238	990	235,620.00	-	kumbull, fiq, etj	-	-	28,700	264,320.00	SPATHAR	
27	Ashta HPP	Shkelzen	Muhamet	Behari	PEMETORE	1466	47/6	750	750	399	299,250.00	-	fasule, ulli, etj	-	-	704,600	1,003,850.00	VAU DEJAS	
28	Ashta HPP	Shtjefen	Lazer	Ndoci	ARE	3498	108/5	684	684	314	214,776.00	-	kumblla, mana, etj	-	-	216,300	431,076.00	SPATHAR	

29	Ashta HPP	Shtjefen	Gjergj	Preci	ARE	3498	108/2	228	79	314	24,806.00	-	hardhi, fiq	-	-	293,100	317,906.00	SPATHAR	
30	Ashta HPP	Tom	Pjeter	Kola	PEMETORE	3498	109/5	649	649	314	203,786.00	-	kumbull, fiq	-	-	61,500	265,286.00	SPATHAR	
31	Ashta HPP	Tonin	Lazer	Nikaj	ARE	1466	52/11	2,500	1,423	399	567,777.00	-	-	-	-	0	567,777.00	VAU DEJAS	
32	Ashta HPP	Vitor	Gjergj	Deja	PEMETORE+TRUALL	1466	51/4	500	156	2121	330,876.00	-	hardhi, moll, etj	-	-	153,700	484,576.00	VAU DEJAS	
33	Ashta HPP	Vitor	Gjergj	Deja	VINEYARD	1466	57/2	500	500	399	199,500.00	-	qershi	-	-	300,000	499,500.00	VAU DEJAS	
34	Ashta HPP	Vitore	Zef	Nikaj	PEMETORE	1466	52/13	7,500	3,280	399	1,308,720.00	-	-	-	-	0	1,308,720.00	VAU DEJAS	
35	Ashta HPP	Xhaferr	Rasim	Selimi	VINEYARD	1466	49/6	1,100	280	399	111,720.00	-	perime, hardhi, etj	-	-	153,500	265,220.00	VAU DEJAS	
36	Ashta HPP	Zef	Dod	Preci	ARE+PEMETORE	3498	109/6	703	703	314	220,742.00	-	fiq, hardhi, etj	-	-	107,900	328,642.00	SPATHAR	
37	Ashta HPP	Nikoll	Mark	Nikaj	PEMETORE	1466	52/26	5,000	197	399	78,603.00	-	-	-	-	0	78,603.00	VAU DEJAS	
38	Ashta HPP	Valentin	Gjon	Nikaj	PEMETORE	1466	52/29	5,000	491	399	195,909.00	-	-	-	-	0	195,909.00	VAU DEJAS	
39	Ashta HPP	Cesk	Gasper	Deja	ARE+TRUALL	1466	50/4	1,840	575	2121	1,219,575.00	-	jonxh, perim, etj	-	-	245,300	1,464,875.00	VAU DEJAS	
40	Ashta HPP	Sander	Gasper	Gjergji	PEMETORE	1466	47/3	2,192	1,916	399	764,484.00	-	fiq, kumbll, etj	-	-	677,600	1,442,084.00	VAU DEJAS	
41	Ashta HPP	Ilir	Ramiz	Bujari	Are	2702	81/1	15	15	413	6,195,000.00	-	0	-	-	0	6,195,000.00	Mjede	

Shuma në Lekë

39.690.698,00

Shuma në m<sup>2</sup> 44051

Adresa e pronarit është shënuar vetëm në fshat, pasi nuk ekzistojnë adresa të sakta rrugësh.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL .....	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA .....	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 22.7.2010  
Doli nga shtypi më 23.7.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë